



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 742 Akti

Nr. 804 Vendimi
Tiranë, 2.10.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 30.9.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ervin Xhiani**, aktualisht ndihmës ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Xhiani, aktualisht me detyrë ndihmës ligjor, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Brunilda Bekteshi kryesuese dhe Olsi Komici anëtar. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.6.2021 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionerja Brunilda Bekteshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier de Mongeot.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:
 - deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2018.

- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *ka kryer deklarin të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Ervin Xhiani.
 7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishtëm dhe të arsyetuar² mbi subjektin e rivlerësimit.
 8. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
 9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes në datën 23.7.2024, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Ervin Xhiani dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
 10. Subjekti Ervin Xhiani, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 26.8.2024. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 12.9.2024.
 11. Në datën e planifikuar të seancës dëgjimore, pranë Komisionit janë depozituar dy denoncime për subjektin e rivlerësimit Ervin Xhiani. Për këtë shkak, trupi gjykues me vendimin e së njëjtës datë vendosi të riçelë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, për kryerjen e disa verifikimeve shtesë në lidhje me këto denoncime. Subjekti u njoftua për vendimin e trupit gjykues në seancën dëgjimore, e cila u shty për shkak të riçeljes së hetimit administrativ.
 12. Pas kryerjes së verifikimeve shtesë, Komisioni mbylli hetimin administrativ dhe në datën 26.9.2024 njoftoi subjektin për rezultatet e hetimit shtesë në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, i dërgoi subjektit nëpërmjet postës elektronike të gjitha dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe i kaloi subjektit të rivlerësimit

² Me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2023.

barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

13. Subjekti Ervin Xhiani, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 27.9.2024. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, vendosi ta ftojë atë në seancën dëgjimore të datës 30.9.2024.
14. Për një proces të rregullt ligjor, subjektit të rivlerësimit Ervin Xhiani i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 30.9.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.
16. Në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Ervin Xhiani u paraqit dhe u mbrojt vetë, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit Ervin Xhiani ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Z. Xhiani ka qenë i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
19. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
20. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj

për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
22. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
 - ç. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
 - d. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
 - dh. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
 - e. deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
 - ë. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë dy seancave dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
24. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ervin Xhiani, aktualisht me detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

25. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

26. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga z. Ervin Xihani në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ku subjekti ka deklaruar pasuritë:

27. **Apartament³ banimi në përdorim, 75.8 m², ndodhur në Lagjen Nr. *, pall. ***, kati *, rr. "C.M", Pogradec, blerë në shumën 1.000.000 lekë, me pjesë takuese 1/3-at e apartamentit.**

27.1 Për këtë pasuri është deklaruar se është blerë nga prindërit e subjektit me të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit nr. *, pall. **, rr. "C.M", përfituar nga ligji për privatizimin e banesave shtetërore me kontratën e privatizimit datë 17.7.1993, shitur nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., në shumën 1.200.000 lekë.

27.2 **Nga hetimi i Komisionit rezultoi se ASHK-ja⁴ ka konfirmuar se në emër të prindërve të subjektit rezulton e regjistruar pasuria apartament.**

Analiza e fakteve

27.3 Nga verifikimi i akteve të dosjes rezulton se prindërit e subjektit R dhe D.Xh në datën 21.9.1998 kanë nënshkruar një kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., për blerjen e apartamentit në shumën 1.000.000 lekë. Palë shitëse - shtetasit E.M, L.M dhe E.M dhe palë blerëse R dhe D.Xh. Ka rezultuar se kjo pasuri është regjistruar në pronësi të prindërve të subjektit sipas certifikatës së pronësisë për apartamentin me sip. 75.8 m², me nr. pasurie **, vol. *, fq. **, në z. k. ***, rruga "C.M", pall. ***, shk. *, kati *, ap. **.

27.4 Në dosjen e ILDKPKI-së rezulton gjithashtu dhe një kontratë tjetër shitblerjeje e datës 18.5.1998, për shitje të një apartamenti banimi nr. * në Pall. **, rruga "C.M", shk.*, kati *, në Pogradec, në shumën 1.200.000 lekë. Palë shitëse R dhe D.Xh dhe palë blerëse A.I, si dhe një kontratë privatizimi banese nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.1993, e lidhur mes NK Banesa dhe shtetasin R.Xh/babai i subjektit. Nga aktet rezulton se prindërit e subjektit këtë apartament e kanë përfituar sipas kontratës së privatizimit të banesave me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.1993, e lidhur mes NK Banesa dhe shtetasit R.Xh.

Nga hetimi rezultoi se prindërit e subjektit apartamentin e deklaruar nga subjekti si banesë në përdorim e kanë blerë me të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurisë apartament, i përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore". Në vitin 1998, kur është shitur ky apartament, subjekti i rivlerësimit ka qenë 17 vjeç dhe nuk ka përfituar pjesë takuese nga shitja e tij.

³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë pronësie të apartamentit me sip. 75.8 m², me nr. pasurie ***, vol. *, fq. **, në z. k. ***, rruga "C.M", pall. **, shk. *, kati *, ap. **, harta treguese dhe kartela e pasurisë e ZVRPP Pogradec, e apartamentit me sip. 75.8 m², e regjistruar në emër të shtetasit R.S.Xh dhe D.R.Xh, me çmim blerjeje 1.000.000 lekë. Në datën 7.10.2014, me referencë ***, është bërë korrigjimi i gabimit të sipërfaqes.
- Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.9.1998, për blerje apt. nr. **, kati *, pall. **, vlera 1.000.000 lekë. Palë shitëse E.M, L.M dhe E.M dhe palë blerëse R.Xh dhe D.Xh.
- Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.5.1998, për shitje apartamenti banimi nr. *, në Pall. **, rruga "C.M" në Pogradec, me vlerë 1.200.000 lekë. Palë shitëse R dhe D.Xh dhe palë blerëse A.I, si dhe kontratë privatizimi banese nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.1993, e lidhur mes NK Banesa dhe shtetasit R.Xh.

⁴ Me shkresën nr. ***, datë 4.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

Analiza financiare

27.5 Referuar akteve rezulton se apartamenti ku banon subjekti, është blerë në shumën 1.000.000 lekë, në datën 21.9.1998, me të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore, i shitur në datën 18.5.1998. Nga këto akte rezulton se prindërit e subjektit kanë disponuar mjaftueshëm burime financiare për blerjen e këtij apartamenti.

Për sa më sipër, për apartamentin në përdorim:

27.6 Nga aktet rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe aktet e ardhura nga ZVRPP Pogradec, në lidhje me apartamentin në pronësi të prindërve të tij, si dhe shitjen e apartamentit të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore.

✓ Subjekti nuk ka deklaruar saktë pjesën takuese për apartamentin në përdorim, pasi blerës të apartamentit referuar aktit të shitblerjes paraqiten vetëm prindërit e subjektit.

27.7 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

27.8 Në prapësimet e depozituara në datën 26.8.2024, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se prej tij është kuptuar se përveç pronësisë mbi çdo pasuri do duhej deklaruar dhe pjesa e pasurisë në përdorim. Për këtë shkak, subjekti ka deklaruar se apartamenti është në përdorimin e tij në pjesën 1/3-at thjesht për të treguar se në këtë apartament banojnë prindërit e tij, dhe vetë subjekti (3 veta). Subjekti ka cilësuar se nuk disponon të drejta pronësie në këtë apartament. Deklarimi i bërë është vetëm për përdorimin efektiv të pasurisë në 1/3-ën pjesë të tij.

Arsyetimi i Komisionit

27.9 Komisioni, në vlerësim të akteve ligjore, ka konkluduar se prindërit janë pronarë të ligjshëm në këtë pasuri dhe se subjekti nuk ka deklaruar saktë pjesën takuese në 1/3-at, pasi nuk e zotëron atë në bashkëpronësi me prindërit, sipas dispozitave të Kodit Civil. Megjithatë, shpjegimet e dhëna prej tij janë të pranueshme, pasi në deklaratën *Vetting* është deklaruar saktë si apartament në përdorim.

28. Automjet⁵ i llojit “Mercedes-Benz”, me vit prodhimi 2001, në përdorim nga subjekti me kontratë huapërdorjeje⁶. Vlera e deklaruar e automjetit 4.000 euro. 100% në pronësi të babait të subjektit. Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për automjetin në deklaratën *Vetting*.

Hetimi i Komisionit

⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatën e pronësisë, datë 16.9.2014, të automjetit me targë AA **IR në emër të shtetasit R.S.Xh.
- Kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.9.2014, me vlerë 4.000 euro. Palë shitëse A.Sh dhe palë blerëse R.Xh.
- Kontratë huapërdorjeje nr. *** rep., datë 15.9.2014, për marrje automjeti “Daimler Chrysler”, me targë AA *** IR. Palë huadhënëse R.Xh dhe huamarrës Ervin Xhiani.

⁶ Datë 15.9.2014.

28.1 DPSHTRR-ja⁷ ka konfirmuar se shtetasi R.Xh ka të regjistruar automjetin me targë AA *** IR në DRSHTRR-në Korçë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr.***kol., datë 15.9.2014, në shumën 4.000 euro.

28.2 Nga aktet e dosjes rezulton se shitësi i këtij automjeti e kishte blerë në datën 7.8.2014, në shumën 3.000 euro. Nga aktet e dosjes rezulton se ky automjet fillimisht ishte shitur në Itali, në datën 24.7.2017, në shumën 850 euro.

28.3 DPSHTRR-ja ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit Ervin Xihani nuk ka të regjistruar automjet në pronësi të tij.

Burimi i krijimit

28.4 Referuar deklaramentit të pasurisë së babait të subjektit në deklaratën *Vetting*, ky i fundit ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit të ardhurat e krijuara nga biznesi prej vitesh, regjistruar me vendim gjykate nr. ***, datë 7.1.1992.

Analiza financiare

28.5 Duke qenë se subjekti i rivlerësimit në momentin e deklaramentit të pasurisë ka rezultuar në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit, për shkak të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prindërit janë persona të lidhur⁸ me detyrim për të deklaruar pasuritë dhe për të provuar burimin e krijimit të tyre. Për këtë arsye, Komisioni ka kryer analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie sipas tabelës vijuese, ku u morën në konsideratë:

- të ardhurat e prindërve në vite nga pagat, interesat e depozitave dhe pensionet;
- shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së për dy persona;
- investimi në ndërtesën në Pogradec (pjesa takuese për vitin 2006);
- shtesat e depozitave në vite.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për blerjen e automjetit në 2014

Përshkrimi	2006 – 2014
Të ardhura prindërit	7 453 434
Shpenzime jetese	2 785 150
Blerje automjeti 2014	560 440
Investim në ndërtesën në Pogradec	431 033
Depozita në bankë (shitesa)	3 777 567
Rezultati financiar	- 100 755

28.6 Nga analiza financiare e Komisionit rezultoi se prindërit e subjektit kishin pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të blerë automjetin, pasi analiza ka rezultuar me një balancë negative në shumën **-100.755 lekë**.

⁷ Me shkresën nr. ** prot., datë 24.5.2023.

⁸ Pika 13 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

28.7 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pika 5 e Nenit D të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

28.8 Subjekti, për të gjitha pasuritë e krijuara nga prindërit dhe për rezultatet negative që kanë rezultuar nga analiza financiare si gjatë hetimit, ashtu dhe pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se këto pasuri janë krijuar me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i prindërve, i regjistruar prej tyre që në vitin 1992 (të cilat janë trajtuar në detaje, në pikat 32.7 e në vijim dhe 33.18 e në vijim të këtij vendimi).

Vlerësimi i Komisionit

28.9 Komisioni, në vlerësim të të gjithë dokumentacionit të administruar në dosje, vëren se subjekti është përpjekur të provojë burimet e prindërve nga aktiviteti tregtar i ligjshëm, pasi referuar akteve ky aktivitet daton në vitin 1992 e në vijim. Subjekti arriti pjesërisht të provojë pagimin e tatimeve në vite nga prindërit, si dhe faktin që prindërit kanë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore, si të vetëpunësuar në sektorin privat.

28.10 Komisioni vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit nga babai duhet të trajtohet në zbatim të parimeve të objektivitetit e proporcionalitetit, sipas parashikimit të nenit 4, pika 5 e nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar në tërësi rrethanat konkrete të çështjes, si faktin që të ardhurat e prindërve janë krijuar në një periudhë të hershme, kur subjekti ka qenë student dhe në atë periudhë subjekti nuk ushtronte asnjë lloj funksioni, edhe nga hetimi i thellë i Komisionit nuk rezultoi ndonjë indicie, që këto të ardhura të mund të buronin nga veprimtari të paligjshme.

Deklarimi i babait të subjektit, si person i lidhur me subjektin

29. Apartament banimi 75.8 m², ndodhur në Lagjen Nr. **, pall. *, kati *, rr. “C.M”, z. k. ***, Pogradec, zotërimi 50%, në bashkëpronësi me bashkëshorten.**

Kjo pasuri i përket apartamentit në përdorim të deklaruar nga subjekti, të trajtuar më sipër.

30. Automjet tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2001, blerë me kontratën e shitblerjes nr. *, datë 15.9.2014, në shumën 4.000 euro. Zotërimi: 100%.**

✓ Kjo pasuri është trajtuar më lart, pasi është deklaruar nga subjekti.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

31. Aktivitet tregtar⁹, regjistruar si person fizik me vendimin e gjykatës nr. *, datë 7.1.1992, me objekt “Tregtim të artikujve ushqimorë me shumicë e pakicë e më pas aktivitet tregtar**

⁹ Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë regjistrimi në organin tatimor, nr. ***, e personit fizik R.Xh me objekt aktiviteti “Tregtim të artikujve ushqimorë me pakicë”.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë konfirmon: R.Xh, person fizik, me NIPT K***C, në datën 1.1.2000, me status pasiv, në datën 18.3.2011, me objekt aktiviteti “Tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara me mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije e duhan”.

pajisur me NIPT K***C, me aktivitet “Tregtim me pakicë në dyqane jo të specializuara me mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije e duhan”, kaluar në statusin pasiv në datën 18.3.2011;

32. Aktivitet tregtar, regjistruar si person fizik në sistemin informativ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, me NIPT L***N, në datën 1.9.2015, me objekt “Bar-bufe”.

Hetimi i Komisionit

32.1 QKB-ja¹⁰ ka informuar se shtetasi R.Xh është i regjistruar në QKB si person fizik në datën 1.9.2015, me NUIS L*** N. Sipas ekstraktit bashkëlidhur, aktiviteti bar-bufe rezulton me status “çregjistruar” në vitin 2018.

32.2 Shtetasi R.Xh figuron i regjistruar në QKB si person fizik, pajisur me NUIS K***C, me aktivitet bar-bufe me status aktiv.

32.3 DRT Korçë¹¹ ka referuar të dhëna për personin fizik R.Xh, me NUIS L***N, me aktivitet bar-bufe, për periudhën 1.9.2015 – 5.1.2018, mbështetur në të dhënat e sistemit informatik tatimor si vijon:

Periudha	Të ardhura	Fitimi	Tatimi i paguar
2015	385.000	89.000	8.333
2016	549.875	254.075	0
2017	411.675	206.675	0
2018	0	0	0

Ky tatimpagues ka deklaruar dhe paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore brenda afateve ligjore. Subjekti zhvillon aktivitet tregtar në një ambient me qira, për të cilin rezulton se janë kryer pagesat e tatimit në burim brenda afateve ligjore.

32.4 DRT Korçë¹² ka informuar se R.Xh rezulton i regjistruar si person fizik me NIPT K***C, me objekt aktiviteti “Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara me mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije e duhan”, me adresë rr. “K.K”, për periudhën 1.1.2000 – 18.3.2011, kur ka kaluar me status pasiv. Gjatë kësaj periudhe, ky tatimpagues nuk ka kryer asnjë deklaram mbi të ardhurat dhe fitimet, si dhe për deklaramin e kontributeve të sigurimeve shoqërore apo shëndetësore.

32.5 ISSH-ja¹³ ka konfirmuar kontributet e shtetasit R.Xh për periudhën shtator 2015 – janar 2019, me NIPT L***N. Për periudhën janar 2018 – gusht 2019 rezulton i siguruar pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec dhe nga gushti 2019 ka fituar pension pleqërie.

- Vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë konfirmon: R.Xh, person fizik, me NIPT L***N, në datën 1.9.2015, me status aktiv, me objekt aktiviteti “Aktivitete të shërbimit të pijeve kafene dhe bar-bufe, Lagjja Nr. *, Pogradec, tek tregu i fruta-perimeve”.

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023.

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2023.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2023.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023.

32.6 Për sa më sipër, rezultoi se personi i lidhur (babai i subjektit) nuk ka deklaruar të ardhurat e krijuara në vite nga aktivitetet tregtare të ushtruara prej tij si person fizik “Shitje me shumicë e pakicë” dhe “Bar-bufe”.

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të Nenit D të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

32.7 Në prapësimet e depozituara nga subjekti, për problematikat e konstatuara prej Komisionit, ai ka shpjeguar se babai i tij ka ushtruar aktivitet tregtar me licencë sipas vendimit nr. ***, datë 7.1.1992, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Kjo licencë ka qenë aktive në vazhdimësi dhe në bazë të saj ka ushtruar aktivitet tregtar deri në momentin (viti 2003) që është regjistruar dhe pajisur me NIPT K***C për ushtrim aktiviteti tregti me pakicë.

32.8 Subjekti ka shpjeguar se në datën 10.7.2024 i është drejtuar DRT-së Korçë për t’i vënë në dispozicion dokumentacionin që dispononin në lidhje me aktivitetin tregtar të ushtruar nga prindërit e tij që prej vitit 1992 e në vijim.

32.9 Në përgjigje të kërkesës së subjektit, DRT-ja Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2024, ka vënë në dispozicion dokumentacionin e disponuar prej tyre në lidhje me aktivitetin e ushtruar nga babai i tij. Dokumentacioni provon se babai i subjektit R.Xh ka qenë i regjistruar për ushtrim aktiviteti tregtar me vendim gjyqësor nr. ***, datë 7.1.1992 dhe në bazë të kësaj licence ka ushtruar aktivitet duke realizuar edhe fitime.

32.10 Nga dokumentacioni i DRT-së Korçë rezulton se gjatë periudhës 1996 – 2005 shtetasi R. Xh ka ushtruar aktivitet tregtar, ka paguar detyrimet tatimore, taksat vendore dhe nga dokumentacioni i vënë më parë në dispozicion nga ISSH-ja rezulton se ai ka paguar edhe sigurimet shoqërore. Gjithashtu, nga shkresa nr. *** prot., datë 6.8.2024, e DRT-së Korçë, rezulton se për vitet 1992 – 1997 shumica e dokumenteve nuk gjenden, pasi u dëmtuan në trazirat e ndodhura në mars të vitit 1997.

32.11 Subjekti ka shpjeguar se mosgjethja e dokumentacionit nuk do të thotë që prej babait të tij nuk është ushtruar aktivitet tregtar dhe nuk janë deklaruar të ardhurat apo nuk janë paguar detyrimet tatimore. Për sa kohë që në bazë të së njëjtës licencë (dhënë në vitin 1992) ai ka ushtruar aktivitet tregtar që prej vitit 1996 deri në vitin 2003, provuar me dokumentacionin e DRT-së Korçë, logjikisht të çon në konkluzionin se ai ka ushtruar aktivitet tregtar që në momentin që është pajisur me këtë licencë, pra që në vitin 1992, edhe pse jo për faj të tij ky dokumentacion nuk mund të gjendet.

32.12 Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se prindërit e tij kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore si të vetëpunësuar prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (fakt i konfirmuar nga ISSH-ja), i cili është një provë thelbësore që tregon se ata në mënyrë të vazhdueshme kanë ushtruar aktivitet tregtar.

32.13 Veç sa më sipër, subjekti ka kërkuar nga Komisioni që të mbahet parasysh fakti se në kohën që prindërit e tij kanë ushtruar aktivitet tregtar, dhe më së shumti në vitet 1992 – 2006, ekonomia e vendit ka qenë kryesisht informale. Personat që mund të ushtronin aktivitet tregtar ose nuk

regjistroheshin fare pranë organeve tatimore, ose mund të rezultonin të regjistruar pranë organeve tatimore për ushtrim aktiviteti, por nuk deklarorin të ardhura, apo deklarorin të ardhura minimale. Në këtë arsyetim, subjekti ka pretenduar se prindërit e tij, në kundërshtim me situatën e informalitetit në vend, kanë provuar se kanë ushtruar aktivitetet tregtar të ligjshëm, pasi kanë përmbushur detyrimet ligjore të kohës për regjistrim të aktivitetit.

Arsyetimi i Komisionit

32.14 Pasi analizoi të gjitha provat e administruara, si dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti është përpjekur të provojë burimet e ligjshme të prindërve nga aktiviteti tregtar, duke provuar kështu me akte shkresore aktivitetin tregtar të prindërve nga viti 1992 e në vijim. Subjekti arriti të provojë pjesërisht pagimin e tatimeve në vite nga prindërit, si dhe faktin që prindërit kanë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore si të vetëpunësuar në sektorin privat.

32.15 Gjithashtu, subjekti nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 6.8.2024, të DRT-së Korçë, ku referohet se për vitet 1992 – 1997 shumica e dokumenteve nuk gjenden, pasi u dëmtuan në trazirat e ndodhura në mars të vitit 1997, referuar dhe pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, arriti të provojë pamundësinë objektive të tij për të gjetur dhe disponuar dokumentacion për pagesën e tatimeve.

32.16 Me gjithë shpjegimet dhe provat e depozituara në lidhje me aktivitetin e prindërve, subjekti nuk arriti të japë shpjegime shteruese në lidhje me të ardhurat e prindërve në vite, qoftë dhe në mënyrë deklarative.

DEKLARIMI I NËNËS SË SUBJEKTIT

33. Ndërtesë¹⁴ me sipërfaqe totale 122.4 m², 3 kate, ndodhur në Lagjen Nr. *, rr. “K.K”, në Pogradec, në procedura legalizimi sipas kërkesës nr. * prot., datë 11.9.2006. Nëna e subjektit ka deklaruar si vlerë ndërtimi shumën 1.927.262 lekë.**

33.1 Burimi i krijimit të deklaruar: të ardhurat e biznesit familjar dhe kursimet ndër vite. Punimet janë kryer nga punëtorë sezonalë dhe pagesat në mënyrë periodike sipas mundësive financiare, por sipas preventivit të bërë vlera edhe sipas mandatarkëtimit është 1.927.262 lekë. Pjesa takuese: 100% në pronësi të nënës së subjektit.

Hetimi i Komisionit

33.2 Drejtoria ALUIZNI Korçë¹⁵ konfirmon se D.Xh rezulton aplikuese me vetëdeklarimin nr. prot. ***, datë 11.9.2006, me objekt “Ngritje kati dyqanet tek tregu + CSH”, certifikatë pronësie të datës 25 shtator 1998, të Zyrës Hipotekës Pogradec, ku konfirmohet pronësia e D.Xh të një lokali tregtie, i formës 1-katësh, në Lagjen Nr. *. Bashkëlidhur akteve rezulton dhe leja e ndërtimit me nr. vendimi KRRT-je **, datë 10.8.2000, rikonstruksion dyqani 1 kat + çati e shfrytëzuar mbi

¹⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës (Aneks nr. 4/7):

- Kërkesë drejtuar Bashkisë Pogradec nr. *** prot., datë 11.9.2006, nga shtetasja D.Xh, sipas formularit për vetëdeklarim pranë ALUIZNI-t për legalizim “Ngritje kati dyqani ekzistues tek tregu+CSH”; certifikatë pronësie të datës 25 shtator 1998, të Zyrës Hipotekës Pogradec, ku konfirmohet pronësia e D.Xh, të një lokali tregtie, i formës 1-katësh në L. *; lejen e ndërtimit nr. vendimi të KRRT-së **, datë 10.8.2000, rikonstruksion dyqani 1 kat + çati, e shfrytëzuar mbi sip. shesh 248.5 m², me gjithë praktikën e plotë, si dhe mandatarkëtim të datës 22.5.2008, arkëtuar nga shtetasja D.Xh, 2% të preventivit 38.545 lekë. Vlera totale e preventivit 1.927.262 lekë.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

sip. shesh 248.5 m², me gjithë praktikën e plotë, si dhe urdhërpagesë e datës 13.5.2008, me investitor shtetasen D.Xh, sip. totale për legalizim 76.71 m² x 25 124 lekë/m² = 1.927.262 lekë (vlera e preventivit) dhe 2% të preventivit (taksë infrastrukture) 38.545 lekë (aneks nr. 29).

33.3 FSHU-ja¹⁶ ka informuar se në emër të shtetasës D.Xh, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi me energji elektrike në instancën e Pogradecit, në rr. “K.K”. Rezulton se për këtë abonent ka konsum jo të rregullt të energjisë elektrike, por duket që herë pas here kjo pasuri është përdorur.

33.4 Pasi u pyet nga Komisioni për këtë ndërtim, subjekti ka shpjeguar¹⁷ se: “Me vendimin nr. **, datë 16.11.1992, të Këshillit të Bashkisë Pogradec, është vendosur që punonjësit të ish-markatës, ndër të cilat ka qenë edhe nëna ime D.Xh, t’u jepet vend për lokal privat tek tregu fshatar. Në këto kushte, nëna ime ka marrë një vend për dyqan nga ish-markata dhe ka ndërtuar një dyqan [bashkëngjitur edhe preventivi i dyqanit në vlerën 171.061 lekë (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e një lek të vjetër në atë kohë)]. Në vijim, nëna ime ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë, me qëllim fitimin e pronësisë mbi këtë dyqan dhe me vendimin nr. ***, datë 5.5.1995, të Gjykatës së Rrethit Pogradec, i është pranuar padia dhe i është njohur e drejta e pronësisë mbi një lokal tregtie njëkatësh. Nga matjet e para rezulton se sipërfaqja e këtij lokali ka qenë 26 m². Për këtë lokal është dhënë edhe certifikata e pronësisë, datë 25.9.1998.

33.5 Më pas, me vendim të KRRT-së nr. **, datë 10.8.2000, të Bashkisë Pogradec, është dhënë një leje ndërtimi kolektive për të gjithë bllokun e dyqaneve të ndërtuara prej vitit 1992-shit tek ish-markata, për ndërtimin e 1 (një) kati dhe 1 (një) çati e shfrytëzuar. Preventivi për ndërtimin e 1 kati dhe 1 çatie nuk disponohet nga ana e prindërve të mi dhe nga kërkimet që unë kam kryer pranë ASHK-së, nuk më është vënë në dispozicion ndonjë akt i tillë. Pasi më keni dërguar këto pyetje për sqarim, prindërit e mi janë interesuar tek fqinjët e këtij ndërtimi, që kanë kryer të njëjtin ndërtim në bazë të lejes kolektive, dhe që aktualisht banojnë aty, nëse dispononin ndonjë dokument dhe nga shtetasja V.N, kufitare e pronës, u është vënë në dispozicion një pagesë për ndërtimin, ku rezulton se vlera e preventivit ka qenë 999.020 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëzet) lekë. Gjithashtu, dua të sqaroj se edhe në bazë të çmimeve të referencës për kostot e ndërtimit në këtë kohë për qytetin e Pogradecit, ndërtimi rezulton për afërsisht në të njëjtën vlerë.

33.6 Në bazë të kësaj leje ndërtimi, në vitin 2000 – 2001 është ndërtuar kati i parë i banimit mbi dyqanin, me sipërfaqe rreth 26-30 m² (matjet e bëra nga institucionet kanë qenë të ndryshme gjatë viteve), ndërsa u hodh vetëm karabina e katit të dytë (çati e shfrytëzuar). Në kushtet kur të gjithë pronarët e tjerë të këtij blloku banesash po ngrinin kate të tjera shtesë, jashtë lejes së ndërtimit, edhe nga prindërit e mi vazhdoi ndërtimi i një kati tjetër shtesë dhe i çatisë, mbi katin e parë të banimit, që ishte ngritur mbi bazën e lejes së ndërtimit nr. *** të vitit 2000. Kati i dytë shtesë i banimit dhe çatia janë ndërtuar në vitet 2002 – mesi i vitit 2006 dhe në datën 11.9.2006, me kërkesën me nr. *** prot., i është kërkuar Bashkisë Pogradec legalizimi i kësaj shtese ndërtimi të kryer mbi atë të dhënë me leje ndërtimi nr. ** të vitit 2000. Në bazë të kërkesës për legalizim janë kryer matjet nga Bashkia Pogradec dhe ka rezultuar se sipërfaqja e shtesës ka qenë 76.71 m². Edhe në këtë rast nga prindërit e mi nuk disponohet preventiv, megjithatë nga ASHK-ja më është

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2023.

¹⁷ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me email-in e datës 7.6.2024.

vënë në dispozicion një urdhërpagesë, që është kryer për ndërtim shtesë, nga rezulton se preventivi ka qenë në vlerën 1.927.262 (një milion e nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, e cila, e ndarë në 5 vite, rezulton në vlerën 385,452.4 (treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy pikë katër) lekë për secilin vit. Ndërtimi është kryer nga ana e prindërve të mi në varësi edhe të të ardhurave që realizonin për një vit nga puna e tyre në tregti, për këtë arsye ndërtimi është kryer në harkun kohor të 5-6 viteve.

33.7 Që nga viti 2008 dhe deri në vitin 2020, nga ana e prindërve të mi nuk është kryer asnjë ndërhyrje tjetër në këtë objekt. Në datën 5.5.2020, prindërit e mi kanë bërë kërkesë për rikonstruksionin e çatisë, Bashkia Pogradec nëpërmjet shkesës nr. *** prot., datë 8.5.2020, ka kthyer përgjigje, duke u bërë me dije prindërve të mi se për rikonstruksionin e saj nuk nevojitej pajisja me leje ndërtimi. Ata e kanë vlerësuar të nevojshme kryerjen e rikonstruksionit të çatisë për shkak të viteve që kishin kaluar dhe pasi mbi objektin e ndërtuar që nuk ishte vënë dorë prej gati 14 vitesh, çatia ishte amortizuar. Ndërtimi i saj është kryer nga punëtorë të thjeshtë sezonalë dhe nga vetë babai im, që ka punuar fizikisht vetë për rikonstruksionin e saj. Nuk disponojmë situacione për ndërtimin e saj, por nga thëniet e babait tim vlera e saj mund të ketë qenë rreth 350.000 (tre qind e pesëdhjetë mijë) lekë.

33.8 Në vitin 2021 është kryer verifikimi i objektit dhe nga punonjësit e ASHK-së Pogradec janë kryer matjet e të gjitha kateve të objektit, dhe konkretisht ka rezultuar se:

Kati përdhe është dyqan, me funksion socio-ekonomik, me sipërfaqe ndërtimi 40.8 m², ku është bërë një shtesë shkallësh me sipërfaqe 0.8 m² dhe sipërfaqe funksionale 33.2 m².

Kati i parë i banimit ka sipërfaqe totale ndërtimi 40.8 m², duke përfshirë këtu një sipërfaqe shtesë anësore 1.7 m² dhe sipërfaqe banimi 40.8 m².

Kati i dytë i banimit, me sipërfaqe ndërtimi dhe banimi 40.8 m².

Kati i tretë (çati e shfrytëzuar, që më pas nga ASHK-ja është vlerësuar si kat), me sipërfaqe ndërtimi 40.8 m².

33.9 Pra, sipërfaqja totale e ndërtimit me funksion banimi (2 kate dhe çati e shfrytëzuar apo kat, siç është vlerësuar më vonë nga ASHK-ja) është 122.4 m², nga të cilat 83.3 m² është shtesë, që është legalizuar me lejen e legalizimit ***, datë 29.10.2021.

33.10 Trualli ku është ngritur ndërtimi, me sipërfaqe 40.8 m², ka qenë në pronësinë e “shtetit” dhe, në bazë të formularit të pagesës së parcelës ndërtimore dhe faturës për arkëtim, rezulton të jetë paguar nga prindërit e mi në vlerën totale 198,808 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetë) lekë, nga të cilët 99,404.10 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e katër pike dhjetë) lekë janë paguar në bono thesari, ndërsa vlera prej 71,570.95 (shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë nëntëdhjetë e pesë) lekësh janë paguar në lekë.

33.11 Sqaroj se prindërit e mi nuk disponojnë situacion për punimet e kryera dhe, nga gjithë kërkimet që kam kryer, pasi më keni kërkuar këto shpjegime, është bërë e mundur vetëm gjetja e dokumenteve siç i kam sqaruar më sipër. Mungesa e situacioneve lidhet edhe me faktin që ndërtimet janë kryer nga punëtorë sezonalë dhe nga vetë prindërit e mi, që kanë punuar fizikisht në ndërtim. Kaq më është sqaruar prej tyre. Dua të theksoj se unë nuk kam pasur njohuri se si

është kryer ky ndërtim nga prindërit, për shkak se në vitet që është kryer ky ndërtim, kam qenë student në Rumani dhe nuk e kam parë ndërtimin e kryer, apo të kem pasur dijeni për shpenzimet që mund të kenë kryer prindërit e mi në ndërtimin e këtij objekti, pasi vetë nuk kam pasur asnjë kontribut në ndërtimin e tij”.

Analiza e fakteve

33.12 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, nga verifikimi i akteve për ndërtimin e kryer nga prindërit e subjektit ka rezultuar se:

a. Me vendimin nr. ***, datë 16.11.1992, të Këshillit Bashkiak Pogradec, ish-punonjësve të markatës së qytetit, ndër të cilët ka qenë edhe nëna e subjektit D.Xh, u është dhënë një truall për të ndërtuar lokal privat tek tregu fshatar, bazuar në ligjin nr. 7572/1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.

b. Fillimisht znj. D.Xh/nëna e subjektit ka ndërtuar një dyqan në katin e parë.

c. Në vijim, me vendimin nr. ***, datë 5.5.1995, të Gjykatës së Rrethit Pogradec, znj. D.Xh i është njohur e drejta e pronësisë mbi një lokal tregtie njëkatësh. Nga matjet e para rezulton se sipërfaqja e këtij lokali ka qenë 26 m². Për këtë lokal është dhënë edhe certifikata e pronësisë, datë 25.9.1998.

ç. Më pas, me vendimin e KRRT-së nr. **, datë 10.8.2000, të Bashkisë Pogradec, është dhënë një leje ndërtimi kolektive për të gjithë bllokun e dyqaneve të ndërtuara prej vitit 1992 tek ish-markata, për ndërtimin e 1 (një) kati dhe 1 (një) çatie të shfrytëzuar.

Në bazë të kësaj leje ndërtimi, në vitet 2000 – 2001 është ndërtuar kati i parë i banimit mbi dyqanin, me sipërfaqe rreth 26-30 m².

Nga prindërit e subjektit u ndërtua një kat tjetër shtesë dhe kati i çatisë mbi katin e parë të banimit, që ishte ngritur mbi bazën e lejes së ndërtimit nr. **, viti 2000. Kati i dytë shtesë i banimit dhe çatia janë ndërtuar në vitet 2002 deri në mesin e vitit 2006.

d. Me kërkesën me nr. *** prot., të datës 11.9.2006, i është kërkuar Bashkisë Pogradec legalizimi i kësaj shtese ndërtimi të kryer mbi atë të dhënë me leje ndërtimi nr. *** të vitit 2000. Në bazë të kërkesës për legalizim janë kryer matjet nga Bashkia Pogradec dhe ka rezultuar se sipërfaqja e shtesës ka qenë 76.71 m².

dh. Me vendimin nr. ***, datë 29.10.2021, është bërë legalizimi i ndërtimit pa leje në pasurinë me nr. ***, z.k. ***, i cili ka të ngritura 4 kate. Referuar akteve rezulton se sipërfaqja totale e ndërtimit me funksion banimi (2 kate dhe çati e shfrytëzuar apo kat siç është vlerësuar më vonë nga ASHK) është 122.4 m², nga të cilat 83.3 m² është shtesa e legalizuar me lejen nr. ***, datë 29.10.2021.

e. Ndërtimi është kryer nga prindërit e subjektit për një periudhë 5 – 6 vite, gjatë periudhës 2000 – 2006, periudhë kur subjekti ka shpjeguar se ka qenë student në Rumani.

ë. Ka rezultuar se prindërit e subjektit me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2023, ia kanë shitur këtë ndërtesë shtetasit V.S në shumën 7.800.000 lekë.

f. Subjekti ka shpjeguar se deri në momentin e shitjes së objektit banesa nuk është përdorur asnjëherë nga familja e subjektit, ndërsa dyqani është përdorur rreth viteve 1992 – 1995 si njësi tregtare nga prindërit e tij.

Analiza financiare

33.13 Në kushtet kur pasuria ndërtesë 3 kate është pasuri e cila disponohet nga nëna e subjektit dhe deklarohet në deklaratën *Vetting*, Komisioni ka kryer analizën financiare në lidhje me kostot për ndërtimin e kësaj godine. Në kushtet kur objekti është një ndërtim pa leje, i legalizuar, si dhe në mungesë të dokumentacionit teknik të kohës kur është kryer ndërtimi (situacion faktik punimesh, preventiva), Komisioni ka arsyetuar se për një qëndrim objektiv, si dhe referuar praktikave të mbajtura në raste analoge, kostoja e ndërtimit të godinës 122.4 m² duhej të llogaritej duke marrë si referencë çmimet e EKB-së për periudhën 2000 – 2006, sipas tabelës vijuese ku vlera totale e ndërtimit ka rezultuar në shumën totale 3.141.795 lekë.

Tabela nr. 2 - Llogaritja e kostos së ndërtimit të godinës 2000 – 2006

Periudha		2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	Total
Sipërfaqja ne m2	122,4	17,5	17,5	17,5	17,5	17,5	17,5	17,4	
Cnimi sipas EKB		26 117	24 933	27 927	25 749	25 069	25 127	24 772	
Kosto e ndërtimit		456 674	436 328	488 723	450 608	438 708	439 723	431 033	3 141 795

33.14 Në analizën e kryer nga Komisioni për periudhën 1994 – 2006 janë marrë në konsideratë:

- të ardhurat e prindërve në vite nga pagat dhe interesa të depozitave;
- shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së për dy persona;
- investimi në ndërtesën në Pogradec për periudhën 2000 – 2006;
- shtesat e depozitave në vite deri në vitin 2006;

Tabela nr. 3 - Analiza financiare mbi krijimin e depozitave dhe ndërtimin e godinës deri në 2006

Përshkrimi	1994 – 2006
Të ardhura prindërit	2 119 635
Shpenzime jetese	2 023 896
Investim në ndërtimin në Pogradec	3 141 795
Depozita në bankë	16 480 000
Rezultati financiar	- 19 526 055

33.15 Nga analiza e kryer rezultoi se prindërit e subjektit kishin mungesë burimesh të ligjshme për të investuar në ndërtesën në Pogradec, për të krijuar depozitat dhe për të përballuar shpenzimet e jetesës, pasi kanë rezultuar me një balancë negative në shumën **19.526.055 lekë** për periudhën e analizuar.

Konstatime të Komisionit

33.16 Për pasurinë ndërtesë me sip. 122.4 m² nga hetimi rezultoi se:

- Personi i lidhur, nëna e subjektit, nuk ka deklaruar saktë pasurinë ndërtesë, pasi nuk ka referuar informacione si sipërfaqja totale e ndërtimit, periudha e ndërtimit, e ndodhur në Lagjen Nr. *,

rruga “K.K”, Pogradec, dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, të situacionit preventiv të punimeve për ndërtimin e objektit.

- Prindërit e subjektit rezultuan në mungesë burimesh të ligjshme financiare për investimin e kryer në objektin 3 kate + çati e ndodhur në Lagjen Nr. *, rruga “K.K”, Pogradec, si dhe krijimin e depozitave në shumën totale prej **19.526.055 lekësh**.

33.17 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të Nenit D të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33.18 Në prapësimet e depozituara në datën 26.8.2024, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që Komisioni të bëjë një rivlerësim të situatës financiare të prindërve të tij, duke marrë parasysh faktet për aktivitetin tregtar të ushtruar nga prindërit që prej vitit 1992 e në vijim. Subjekti ka pretenduar se në rast se Komisioni do të pranojë shpjegimet e dhëna më sipër për të ardhurat nga aktiviteti tregtar, balanca negative mund të mos ekzistojë apo të jetë shumë herë më e vogël se ajo që ka rezultuar deri në këtë moment.

33.19 Gjithashtu, subjekti evidenton se prej tij është konstatuar se në analizën financiare të Komisionit në asnjë moment nuk janë mbajtur parasysh interesat që mund të kenë rezultuar nga depozita bankare e prindërve të tij. Nga një përlllogaritje e thjeshtë matematikore, duke pasur parasysh formulën e përdorur nga bankat për llogaritjen e interesave bankarë, ku K (kapitali) = K_n (kapitali fillestar) $\times (1+R/100)^n$ do të rezultonte se vlera e kapitalit fillestar që mund të jetë vendosur në bankë nga prindërit e tij që prej vitit 1993 (edhe pse nga nëna e tij deklarohet se ka hapur llogari bankare pak kohë pasi ajo ka filluar punë, pra rreth mesit apo fundit të viteve '80, megjithatë për referencë është marrë viti 1993, pasi prej këtij viti disponohet informacion nga Banka e Shqipërisë për normat e interesit të depozitave bankare), do të ishte afërsisht 3.000.000 lekë. Madje, kjo vlerë do të rezultonte nëse prindërit e tij do të tërhiqnin interesat pas çdo viti. Nëse interesat do t'i shtohen shumës së vitit pasardhës, atëherë vlera fillestare me të cilën është krijuar depozita do të rezultojë edhe më e vogël se 3.000.000 lekë.

33.20 Subjekti ka pretenduar se prej Komisionit është vlerësuar periudha kohore 1994 – 2006, por nuk është marrë parasysh fakti që babai i tij ka filluar punë që prej vitit 1971, ndërsa nëna e subjektit është punësuar që prej vitit 1981 dhe gjatë këtyre viteve ata kanë përfituar pagat takuese, prej të cilave edhe kanë kursyer. Nëse Komisioni do merrte në konsideratë këto fakte dhe t'i pasqyronte të ardhurat e prindërve në analizën financiare, kjo e fundit do ndryshonte.

33.21 Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se si gjatë hetimit, ashtu dhe në prapësimet e depozituara, se të ardhurat e krijuara nga prindërit dhe gjendja negative që ka rezultuar për pasuritë e tyre, janë të ardhura të krijuara prej tyre nga aktiviteti privat, gjatë një periudhe që ai ka qenë minorene apo student. Subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit se depozita e prindërve në Raiffeisen Bank ishte çelur për herë të parë në vitin 2005, në shumën 10.718.884 lekë, si dhe ndërtimi i godinës 3 kate kishte përfunduar në vitin 2006, ndërkohë që subjekti ka përfunduar studimet universitare në Rumani, në vitin 2006. Nga këto rrethana duket qartësisht që këto të ardhura janë krijuar prej punës së tyre.

Arsyetimi i Komisionit

33.22 Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dokumentacionit të administruar, trupi gjykues vlerëson të evidentojë faktin se nga hetimi nuk rezultoi ndonjë e dhënë që subjekti të mund të kish kontribuar në krijimin e likuiditeteve bankare apo në krijimin e ndonjë pasurie. Gjithashtu, mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe investimeve të kryera në vite nga prindërit e subjektit i përket një periudhe përpara se subjekti të merrte detyrën e ndihmësit ligjor. I ndodhur në këto rrethana, ky rast duhet të trajtohet në zbatim të parimeve të objektivitetit e proporcionalitetit, sipas parashikimit të nenit 4, pika 5 e nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

33.23 Por gjithashtu, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit provoi pamundësinë objektive (parashikuar nga pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016) për të disponuar dokumentacion dhe, pas përpjekjeve reale të kryera nga ana e tij, për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të siguruara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të prindërve të tij për periudhën 1992 – 1997, çka do të reduktonte ndjeshëm balancën negative të rezultuar nga ana e Komisionit.

33.24 Pasuria ndërtesë 3 kate, me sip. 122.4 m², në pronësi të personit të lidhur, nënës së subjektit, është ndërtuar gjatë periudhës 1992 – 2006. Gjithashtu, depozita e nënës së subjektit është krijuar në vitin 2006. Për të dyja këto pasuri të krijuara nga prindërit e subjektit ka rezultuar balancë negative në shumën prej 16.8 milionë lekësh. Komisioni, i gjendur para disa rrethanave dhe fakteve, si:

i) në periudhën e krijimit të këtyre pasurive subjekti i rivlerësimit ka qenë duke ndjekur studimet në Rumani, përkatësisht në vitet 2001 – 2006.

ii) Subjekti i rivlerësimit ka filluar të ushtrojë funksionet e ndihmësit ligjor në datën 18.6.2015, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Këto fakte përjashtojnë tej çdo dyshimi se subjekti ka pasur mundësi të ndikojë nëpërmjet abuzimit me detyrën e tij në krijimin e pasurive apo likuiditeteve bankare, duke ardhur në një frymë pajtuese me vetë qëllimin e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, që synojnë nxjerrjen nga sistemi të individëve që kanë abuzuar me detyrën për përfitime personale.

33.25 Nga hetimi rezultoi se këto pasuri janë në pronësi të nënës së subjektit të rivlerësimit dhe duken se janë krijuar me të ardhurat e fituara të prindërve përgjatë viteve të punës, nga aktiviteti i tyre privat. Gjatë hetimit, rezultoi e provuar se prindërit e subjektit kanë ushtruar aktivitet tregtar të ligjshëm në vite, duke u regjistruar babai z. R.Xh si person fizik, me vendim gjykate që në vitin 1992, si dhe regjistruar në vijim në QKB, për të ushtruar aktivitet tregtar. Subjekti arriti të provonte se prindërit e tij në vite kishin shlyer pjesërisht detyrimet tatimore, si dhe kanë derdhur kontributet tek sigurimet shoqërore si të vetëpunësuar në sektorin privat.

33.26 Nga aktiviteti privat i prindërve të subjektit, megjithëse nuk provohen plotësisht të ardhurat e ligjshme të pretenduara prej tyre, rezultojnë fakte që dëshmojnë për kontributin real të personave të lidhur për të siguruar të ardhura me qëllim mbajtjen e familjes dhe shkollimin e subjektit në një shtet të huaj si Rumania. Kjo rrethanë për ligj përdorimin e çdo burimi financiar për financimin e saj, si një obligim familjar të prindërve, veçanërisht brenda kontekstit të realitetit shqiptar. Këto

përpjekje e veprime të kryera nga personat e lidhur, kur subjekti i rivlerësimit nuk kishte funksionet e ndihmësit, nuk mund të penalizojnë karrierën e tij të mëpasshme.

33.27 Vlen të theksohet fakti se në krijimin e këtyre pasurive nuk rezultoi ndonjë kontribut financiar i subjektit të rivlerësimit apo përfshirje e tij në ndonjë formë apo me nënshkrimin e ndonjë akti ligjor, që të mund të lidhte subjektin me krijimin e këtyre pasurive. Pasuritë e krijuara, për të cilat subjekti nga analiza financiare ka rezultuar me balancë negative, nuk vërtetohet se janë në pronësi të subjektit të rivlerësimit, janë krijuar nga prindërit e tij dhe asnjëra prej tyre, si ndërtesa, edhe depozitat bankare, nuk i kanë shërbyer atij për të kryer ndonjë investim të mëvonshëm.

33.28 Të gjitha këto rrethana dobësojnë peshën specifike të balancës negative, për krijimin e pasurive të prindërve të subjektit. Këto pasuri të krijuara para se subjekti të merrte detyrën e ndihmësit, janë krijuar jashtë ndikimit të subjektit në detyrën e ndihmësit ligjor, pavarësisht faktit se rezulton të mos jetë krejtësisht e mbuluar me të ardhura të ligjshme, sipas standardit të ligjit nr. 84/2016.

33.29 Për sa më sipër arsyetuar, në përfundim, trupi gjykues në çështjen objekt vlerësimi çmon se nuk ka rrethana të tilla që mund të cenojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë apo procesin në tërësi të rivlerësimit të subjektit. Në konkluzionin përfundimtar, trupi gjykues është bazuar thelbësisht në aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë rrethanat e konstatuara të lidhura me pasuri të krijuara para detyrës, në mungesë të kontributit financiar nga subjekti për krijimin e këtyre pasurive, si dhe në mosevidentimin e ndonjë rrethane tjetër për deklarim të rremë, fshehje pasurie apo që të ardhurat të jenë rrjedhojë e ndonjë veprimtarie të kundërligjshme, që mund të cenonte pozitën e tij në këtë proces. Për sa u arsyetua më sipër, ligjshmëria e të ardhurave për pasuritë e prindërve të krijuara para fillimit të detyrës së subjektit, ku ky i fundit nuk rezultoi pronar i ndonjëres prej tyre, dhe në nivelin e provave dhe rrethanave specifike të rezultuara për këtë subjekt, vlerësohen nga trupi gjykues se nuk cenojnë qëllimin e ligjit që normon procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky konkluzion i trupit gjykues, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, gjendet në koherencë edhe me vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) kundër Shqipërisë, ku në paragrafin 96 citohet: *“...Gjykata vlerëson se në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të veçanta të çështjes, shkarkimi i kërkueses, bazuar në thelb në faktin se ajo nuk ishte në gjendje të provonte se burri i saj kishte paguar tatimin mbi disa nga të ardhurat e tij nga aktivitetet e ligjshme në dy dekadat e mëparshme dhe në mungesë të ndonjë treguesi për keqbesim ose shkelje të qëllimshme nga vetë aplikanti, ishin në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i verifikimit”*.

34. Llogari rrjedhëse¹⁸ në shumën 8.026.042,14 lekë, çelur në datën 11.2.2005, në Raiffeisen Bank, zotëruar 100% nga nëna e subjektit, me burim nga aktiviteti tregtar me bashkëshortin, kursime familjare dhe interesa nga bonot e thesarit ndër vite.

¹⁸ Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. ** prot., datë 20.1.2017, lëshuar nga Raiffeisen Invest “Mbi pasqyrën e llogarisë 18.1.2017”. Vlera totale e kuotave është 8.026.042,14 lekë.
- Vërtetim i datës 19.1.2017, i Raiffeisen Bank, të llogarisë rrjedhëse dhe depozitave në lekë dhe USD, si dhe nxjerrjen e llogarisë datë 20.1.2017, e Raiffeisen Bank, për periudhën 30.3.2006 deri 30.12.2016.

Hetimi i Komisionit

34.1 Raiffeisen Bank¹⁹ ka konfirmuar llogari rrjedhëse të znj. D.Xh pranë Raiffeisen Bank.

34.2 Raiffeisen Invest²⁰ ka konfirmuar se nëna e subjektit, znj. D.Xh, është investitore në fondin Raiffeisen Prestigj nga data 8.5.2014 dhe në vijim. Gjendja e llogarisë në fond me datë 14.5.2023 është 8.927.938 lekë.

34.3 QKB-ja²¹ ka konfirmuar se znj. D.Xh figuron e regjistruar në QKB si person fizik, në datën 8.2.2010, pajisur me NUIS L***K, aktivitet bar-bufe. Sipas ekstraktit bashkëlidhur rezulton me aktivitet bar-bufe me status aktiv.

34.4 DPT-ja Korçë²² konfirmon se znj. D.R.Xh është administratore e NIPT-it L***K dhe është regjistruar për zhvillim aktiviteti privat në datën 5.2.2010, me aktivitet “Bar-kafe”, me adresë Rr. I, banesë private Pogradec, Korçë, për periudhën 8.2.2010 – 10.1.2013, statusi “çregjistruar”. Gjatë kësaj periudhe, ky tatimpagues nuk ka kryer asnjë deklaram lidhur me të ardhurat dhe fitimet. Ky tatimpagues ka deklaruar dhe paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e sipërcituar.

34.5 Bashkia Pogradec²³ konfirmon se shtetasja D.R.Xh, e datëlindjes 5.11.1952, është regjistruar si subjekt pranë zyrave të QKB-së në datën 8.2.2010, me aktivitet “bar-bufe”, me NIPT L***K dhe i ka shlyer detyrimet deri në momentin e kërkesës për “çregjistrim”, datë 10.1.2013.

34.6 Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti tregtar privat familjar, për aktivitetet “kafene” dhe “bar-kafe” nuk ka deklarata të ardhurash, sepse nuk rezulton i regjistruar për TAPBV. Gjithashtu, ka detyrime tatimore të palikuiduara në vlerën 620.000 lekë.

Burimi i krijimit

34.7 Në lidhje me burimin e krijimit, personi i lidhur, nëna e subjektit D.Xh, ka deklaruar se burimi i krijimit për të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting* janë nga të ardhurat nga aktiviteti tregtar me bashkëshortin, kursime familjare dhe interesa nga bonot e thesarit ndër vite. Por, referuar deklaramit, nëna dhe babai i subjektit në deklaratën *Vetting* nuk kanë deklaruar sa kanë qenë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar.

Referuar të dhënave të rezultuara gjatë hetimit, ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë qenë të regjistruar si persona fizikë:

- Babai është regjistruar me vendimin e gjykatës nr. **, datë 7.1.1992, me objekt veprimtarie “Tregtim të artikujve ushqimorë me shumicë e pakicë, e me NIPT K***C, kaluar pasiv në datën 18.3.2011 me objekt “Tregtim me pakicë në dyqane jo të specializuara me mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije e duhan”;
- Aktivitet tregtar regjistruar si person fizik në sistemin informativ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, me NIPT L*** N, në datën 1.9.2015 me objekt “bar-bufe”;

¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023.

²⁰ Me shkresën *** prot., datë 16.5.2023.

²¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 25.5.2023.

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

- Nëna e subjektit, znj. D.R.Xh, ka të dhëna se ka qenë e regjistruar me NIPT-in L***K për zhvillim aktiviteti privat, në datën 5.2.2010, me aktivitet “bar-kafe”, për periudhën 8.2.2010 – 10.1.2013, statusi çregjistruar.

34.8 Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga prindërit, për këto aktivitete subjekti ka shpjeguar²⁴: “Nga ana ime nuk disponohet dokumentacion në lidhje me shumën fillestare të lekëve që është depozituar në llogari nga nëna ime dhe as për shumat e depozituara ndër vite. Duke mos pasur të dhëna për këto, nuk mund të paraqes të detajuar as sa ka qenë shuma e realizuar vetëm nga interesat e bonove të thesarit, por nga thëniet e prindërve të mi, në referim të praktikës dokumentare që administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe nga kthimet e përgjigjeve vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, në vijim do të përpiqem të sqaroj se si ka rezultuar shuma e lekëve 8.026.042 lekë në llogarinë e nënës sime.

Konkretisht, për nënën time D.Xh:

- Nëna ime ka filluar punë që në vitin 1981 dhe deri në vitin 1992 ka qenë e punësuar pranë NTSH Pogradec;
- Nga data 1.8.1992 deri më 31.7.1993 rezulton të ketë përfituar një pagesë papunësie;
- Nga data 1.2.1994 deri në datën 31.12.1996, ajo rezulton e vetëpunësuar dhe sipas sqarimeve të saj ka ushtruar aktivitet tregtar shitje me pakicë.
- Nga data 1.1.1997 dhe deri në datën 31.12.1999 ajo ka qenë e vetëpunësuar dhe, sipas sqarimeve të saj, ka ushtruar aktivitet tregtar shitje me shumicë dhe për më tepër që gjatë kësaj kohe, për shkak të gjendjes së luftës, prindërit e mi kanë qenë ndër të paktët që e kanë mbajtur hapur biznesin e tyre, duke përfituar edhe të ardhura më të mëdha, për shkak të mbylljes së shumë bizneseve që ushtronin të njëjtin aktivitet si ata. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kohe rezulton se edhe pagesa e kryer e sigurimeve shoqërore ka një rritje krahasuar me periudhat e mëparshme apo edhe të mëpasshme kohore.
- Nga data 1.1.2000 deri në datën 31.12.2000 ajo rezulton të jetë e vetëpunësuar dhe sipas sqarimeve të saj ka ushtruar aktivitet tregtar shitje me pakicë.
- Nga data 1.1.2002 deri në datën 31.12.2002, nëna ime ka qenë e punësuar pranë “A” shpk;
- Në periudhat kohore 1.1.2003 – 31.12.2003 dhe më pas 1.1.2005 – 31.12.2005, nga vërtetimi i vënë në dispozicion nga ISSH-ja rezulton të ketë përfituar pagesa nga zyra e punësimit Pogradec;
- Nga data 1.1.2004 deri në datën 31.12.2004 ka qenë e punësuar pranë subjektit “A” sh.p.k.;
- Nga data 1.2.2010 deri në fund të vitit 2012 ka qenë e vetëpunësuar në aktivitetin “kafene” dhe “bar-bufë”. Kjo rezulton edhe në bazë të vërtetimit nr. *** prot., datë 28.10.2016, të dhënë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

Për babain tim, R.Xh:

²⁴ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me email-in e datës 10.6.2024.

- *Babai im ka filluar punë që në vitin 1971 dhe deri në vitin 1992 ka qenë i punësuar në ndërmarrje të ndryshme shtetërore.*
- *Nga data 1.4.1992 deri në datën 31.12.1993 rezulton i vetëpunësuar, në referim të vërtetimit të datës 19.9.2018, lëshuar nga ISSH Drejtoria Rajonale Korçë, Agjencia Pogradec. Në bazë të vërtetimit nr. *** prot., datë 4.11.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, rezulton se në arkivin e gjykatës nuk ka vendime regjistrimi për persona fizikë për vitin 1992, duke sqaruar se gjatë trazirave të muajit mars 1997 në Gjykatë janë djegur një numër i konsiderueshëm dosjesh. Nga ana ime u bë e mundur gjetja e një licence në emër të babait tim për ushtrim veprimtarie të artikujve ushqimorë me shumicë, dhënë me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 7.1.1992, me periudhë të veprimtarisë nga janari 1992 deri më 31.12.1993.*
- *Nga data 1.1.1998 deri në datën 31.12.2001, babai ka qenë i vetëpunësuar me aktivitet shitje me shumicë dhe më pas me pakicë. Sqarohet se nëna dhe babai im që pas vitit 1992 e në vijim, përveç vitit 2002 dhe 2004, kur nëna ime ka qenë e punësuar pranë subjekteve private, kanë punuar gjithmonë bashkë dhe herë pajisej nëna me licencë për ushtrim veprimtarie, dhe herë babai. Për periudhën para vitit 2000 nuk kam arritur të gjej ndonjë licencë (përveç asaj të sipërpërmendur) për veprimtarinë e ushtruar nga prindërit e mi, megjithatë nisur nga fakti që sipas praktikës së vënë në dispozicion nga ISSH-ja rezulton se kanë paguar kontribute si të vetëpunësuar, përbën një provë që ata kanë ushtruar aktivitet privat.*
- *Nga data 1.1.2002 deri në datën 31.12.2005 babai im ka qenë i vetëpunësuar me aktivitet tregti me pakicë, i regjistruar në tatime që nga data 1.1.2000 deri në datën 18.3.2011;*
- *Nga data 1.9.2015 deri në fillim të vitit 2018 ka ushtruar aktivitet bar-kafe në referim të kthimit të përgjigjes nr. *** prot., datë 2.11.2016 dhe kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.9.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.*

Pra, rezulton se prindërit e mi që pas vitit 1992 dhe deri në vitin 2011 kanë qenë më së shumti të vetëpunësuar si aktivitet tregtar shitje me shumicë apo me pakicë, duke ndryshuar herë pas here në varësi edhe të kohës kur ushtrohej aktiviteti. Nga prindërit e mi më është sqaruar se në vitet 1992 – 2000, kur kanë ushtruar aktivitet tregtar, kanë realizuar edhe pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre dhe në veçanti në periudhën kohore 1997 – 1998, kur për shkak të gjendjes së luftës kanë qenë ndër të paktët që kanë zhvilluar biznesin e tyre, duke realizuar të ardhura të konsiderueshme”.

34.9 Komisioni mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, me të cilat ka pretenduar të provojë burimet e ligjshme, të cilat do të përfshihen në analizën financiare në vijim.

Historiku i depozitës së çelur në Raiffeisen Bank

34.10 Në lidhje me shumën 8.026.042,14 lekë, deklaruar nga nëna e subjektit në deklaratën *Vetting*, Komisioni ka analizuar historikun e kësaj depozite. Nga verifikimi i këtyre llogarive rezulton se janë çelur përpara se subjekti të ishte në detyrë. Në tabelën vijuese nr. 4 pasqyrohen të dhënat e marra nga *statement*-et bankare për periudhën 2005 – 2016.

Të ardhurat nga interesat bankarë në vite kanë rezultuar afërsisht 6.85 milionë lekë.

Tabela nr. 4 - Depozitat e prindërve të subjektit në vite

Pershkrimi	BKT Depozite D. Xh	RZB Depozite D. Xh	OTP Depozite D. Xh	RZB depozite D. Xh	RZB Prestige	Total
2005		10 718 884				10 718 884
2006		12 180 000	4 300 000			16 480 000
2007		12 962 851	202 268			13 165 119
2008		13 750 000		1 622 090		15 372 090
2009		13 570 000				13 570 000
2010		13 570 000				13 570 000
2011		13 570 000				13 570 000
2012	1 200 000	13 570 000				14 770 000
2013	1 200 000	13 570 000				14 770 000
2014	1 500 000	3 000 000			10 000 000	14 500 000
2015	2 000 000	3 000 000			10 000 000	15 000 000
2016		-			8 026 042	8 026 042

Analiza financiare

34.11 Nëse Komisioni do të verifikonte të ardhurat e ligjshme të prindërve të subjektit, me të dhënat e rezultuara gjatë hetimit dhe aktet e depozituara²⁵ nga subjekti në përgjigje të pyetësorit, për periudhën kur janë krijuar këto depozita, duket se të ardhurat e ligjshme nuk janë të mjaftueshme për krijimin e tyre deri në vitin 2006, sipas tabelës nr. 3, duke rezultuar me balancë negative.

34.12 Sa i përket të ardhurave të krijuara nga aktiviteti tregtar i prindërve të subjektit, referuar informacionit nga DRT-ja Korçë, prindërit e subjektit nuk kanë deklaruar të ardhura dhe fitim, si dhe kanë rezultuar edhe me detyrime të pashlyera sipas të dhënave vijuese.

Tabela nr. 5 - Të ardhurat e aktivitetit të prindërve në vite

Aktivitetet Private sipas shkreses	Dt regjistrimi	Aktiv deri ne dt.	2015	2016	2017	Total
R. Xh PF fitim neto	1.9.2015	2018	80 667	254 075	206 675	541 417
R. Xh PF / dyqan tregti ushqimore	1.1.2000	18.3.2011	Nuk ka deklaruar asnjehere ne tatime xhiro apo fitim apo kontribute			
D. XH pf / bar kafe	8.2.2010	10.1.2013	Asnje deklarim per xhiro dhe fitim - ka detyrime ndaj bashkise ne shumen 620.000 leke			

34.13 Në vijim, në lidhje me mundësinë financiare të prindërve të subjektit në vite për krijimin e depozitave në vitet 2007 – 2015, Komisioni ka analiz

uar të ardhurat nga interesat dhe shpenzimet në vite sipas tabelës nr. 6.

Tabela nr. 6 - Analiza financiare mbi krijimin e shtesave në depozita deri në vitin 2015

Përshkrimi	2007 – 2015
Të ardhura prindërit	7 819 031
Shpenzime jetese	3 014 588
Blerje automjeti	560 440
Depozita në bankë	1 834 881
Rezultati financiar	2 969 562

²⁵ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me *email*-in e datës 10.7.2024.

34.14 Nga analiza financiare e kryer, si dhe nga verifikimet bankare, duket se prindërit kanë pasur mundësi financiare të krijojnë shtesat në depozita nga viti 2007 deri në vitin 2015.

34.15 Sa më sipër duket se:

- Prindërit e subjektit kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës fillestare në emër të nënës deri në vitin 2006, në Raiffeisen Bank (aktualisht depozita në RFZ Invest është në shumën 8.026.042 lekë), pasi nga institucionet përkatëse nuk konfirmohen të ardhurat e ligjshme nga aktivitetet private ndër vite, si dhe rezultojnë detyrime tatimore të palikuiduara.

34.16 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

34.17 Në prapësimet e depozituara prej subjektit në datën 26.8.2024 u dhanë të njëjtat shpjegime, të trajtuara më sipër në lidhje me barrën e provës së kaluar nga Komisioni, për gjendjen negative të rezultuar për depozitën në emër të nënës.

35. Deklarimi i të ardhurave²⁶ të nënës së subjektit

- Pension pleqërie, përfituar nga data 5.11.2012, vërtetuar me vërtetimin nr. *** prot., datë 24.10.2017. Ndër vite është indeksuar në shumën 14.785 lekë/muaj. Shuma totale 739.250 lekë.
- Të ardhura nga aktiviteti tregtar privat familjar, në bashkëpunim me bashkëshortin ndër vite dhe nga interesat bankarë mbi depozitat dhe bonot e thesarit, sipas vërtetimit bankar të datës 19.1.2017. Shuma 2.579.576 lekë.
- Të ardhura nga investimi në Raiffeisen Invest, sipas vërtetimit nr. **, datë 20.1.2017. Shuma 460.570 lekë.

Hetimi i Komisionit

35.1 ISSH-ja²⁷ konfirmon kontributet e shtetasit R.Xh për periudhën shtator 2015 – janar 2019, me NIPT L***N. Për periudhën janar 2018 – gusht 2019 rezulton i siguruar pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec dhe nga gushti i vitit 2019 ka fituar pension pleqërie.

35.2 Gjithashtu konfirmon se shtetasja D.R.Xh nga nëntori 2012 përfitim pension pleqërie.

²⁶ Bashkëlidhur deklaratës (Aneks nr. 4/9):

- Vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Rajonale Korçë për pension pleqërie të shtetasës D.Xh, me datë fillimi 5.11.2012, në masën aktuale 14.785 lekë (nga nëntori 2012 sipas ISSH-së) x 50 muaj, në total 729.465 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 28.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë: tatimpaguesi R.Xh, person fizik me NIPT L***N, me administratore shtetasen M.B, me objekt "Aktivitete të shërbimit të pijeve bar-kafe", ka raportuar të ardhura për vitin 2015 në shumën 385.000 lekë.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 20.1.2017, lëshuar nga Raiffeisen Invest "Mbi pasqyrën e llogarisë 18.1.2017". Vlera totale e fitimit 460.570 lekë (Aneks nr. 4/8).

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023.

35.3 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, në lidhje me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar i prindërve duket se ata nuk kanë provuar me burime të ligjshme të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga aktiviteti tregtar në shumën 2.579.576 lekë.

35.4 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të Nenit D të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

35.5 Në prapësimet e depozituara nga subjekti, ai ka shpjeguar se nuk ka dijeni dhe nuk ka arritur të kuptojë dhe konkludojë nga dokumentacioni që disponon dhe që i është vënë në dispozicion edhe nga Komisioni se përse kjo shumë është deklaruar veçmas nga nëna e tij, pasi vërtetimi bankar që i është referuar, i datës 19.1.2017, është po i njëjti me llogarinë që ka pasur në Raiffeisen Bank që në vitin 2004, e cila më pas ka kaluar në Raiffeisen Invest dhe, përfundimisht, në momentin e deklarimit ka qenë 8.026.042 lekë.

Arsyetimi i Komisionit

35.6 Për Komisionin, deklaratimet e personit të lidhur, nënës, në lidhje me shumën 2.579.576 lekë, e krijuar me të ardhurat nga aktiviteti tregtar privat familjar, në bashkëpunim me bashkëshortin, ndër vite edhe nga interesat bankarë mbi depozitat dhe bonot e thesarit, është deklarim i pasaktë, pasi nuk mbështetet në dokumentacion provues.

36. Gjetje të tjera

36.1 Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 2010 – 2015.

36.2 QKB-ja²⁸ konfirmon se shtetasi Ervin Xhiani figuron të ketë qenë i regjistruar në QKB si person fizik në datën 19.1.2010, pajisur me NUIS (NIPT) L***B, aktivitet “Zyrë avokatie”. Aktualisht figuron me status “çregjistruar” nga data 12.10.2015, sipas ekstraktit bashkëlidhur (aneksit nr. 31).

36.3 DRT-ja Korçë²⁹ konfirmon se subjekti Ervin R Xhiani është regjistruar për zhvillim aktiviteti privat në datën 19.1.2010, me NIPT L***B, me aktivitet kryesor “Aktivitete juridike” dhe figuron me status “Kërkesë për çregjistrim” nga data 28.5.2015. Për sa i përket të ardhurave të realizuara, detyrimeve tatimore etj., tatimpaguesi ka deklaruar si vijon.

Lloji i deklaratës	Viti	Të ardhura	Fitimi në lekë
Tatim mbi të ardhurat personale biznes i vogël	2010	700.000	530.000
Tatim mbi të ardhurat personale biznes i vogël	2011	251.668	146.219
Tatim mbi të ardhurat personale biznes i vogël	2012	110.833	-41.721
Tatim mbi të ardhurat personale biznes i vogël	2013	347.502	128.964

²⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023.

²⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2023.

Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	2014	110.000	126.000
Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	2015	0	-32.000

36.4 Referuar të dhënave të konfirmuara nga DRT-ja Korçë, rezulton se fitimi nga ky aktivitet është rreth 931.000 lekë.

36.5 Për sa më sipër, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat nga aktiviteti “Zyrë avokatie”, me NIPT L***B, i regjistruar në datën 19.1.2010, dhe në datën 12.10.2015 kaluar me status “çregjistruar”.

36.6 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

36.7 Subjekti për të ardhurat e fituara nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë ka shpjeguar se nga këto të ardhura ai nuk ka kryer asnjë lloj investimi apo blerë pasuri. Të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i avokatisë janë konsumuar prej tij për shpenzime jetese dhe, në momentin që subjekti ka plotësuar deklaratën e pasurisë, nuk ka ekzistuar asnjë e ardhur nga aktiviteti që ka ushtruar si avokat. Në këto kushte, subjekti ka vlerësuar se nuk kishte detyrim ligjor për t’i deklaruar. Lidhur me faktin që ka ushtruar këtë aktivitet, prej tij janë dhënë të gjitha deklaratimet dhe dokumentacioni i disponuar.

Arsyetimi i Komisionit

36.8 Komisioni, në vlerësim të të gjitha akteve të administruara, vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë të pranueshme, marrë në konsideratë dhe faktin që subjekti ka deklaruar saktë ushtrimin e aktivitetit të avokatisë për periudhën 2010 – 2015, si dhe ka paguar detyrimet tatimore për këto vite. Pra, në lidhje me këtë aktivitet, përputhen si deklaratimet e subjektit, ashtu dhe të dhënat e gjeneruara nga institucionet shtetërore.

37. Investime të kryera nga nëna e subjektit pas deklaratës *Vetting*

37.1 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se në datën 23.2.2017, periudhë në të cilën subjekti ka qenë në detyrë, nëna e tij D.Xh ka depozituar në banka shumat *cash* si vijon:

- 1.500.000 lekë depozitim në Societe Generale, sot OTP Bank;
- 2.500.000 lekë depozitim në BKT.

37.2 Lidhur me këto depozitime, subjekti u pyet nga Komisioni për të saktësuar këto transaksione, si dhe të provonte burimin e ligjshëm të këtyre depozitimeve në shumën totale prej 4.000.000 lekësh.

37.3 Subjekti ka shpjeguar³⁰ se: “Shuma prej 1.500.000 lekësh, të depozituar në OTP Bank dhe 2.500.000 lekë të depozituar në BKT, nuk janë krijuar rishtazi nga prindërit e mi, pra në vitet pas fillimit të detyrës nga ana ime. Ka qenë shumë e depozituar në llogarinë e nënës sime në Raiffeisen Bank dhe, në tetor të vitit 2016, konkretisht në datën 12.10.2016, është tërhequr nga kjo llogari shuma prej 3.000.000 lekësh dhe në datën 20.12.2016 është tërhequr nga kjo llogari shuma

³⁰ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me *email*-in e datës 10.7.2024.

2.118.750,00 lekë. Qëllimi i nënës sime ka qenë vendosja e shumave në banka të ndryshme jo vetëm për shkak të interesave, por edhe për shkak se mori dijeni të faktit që depozita në bankë sigurohej deri në shumën 2.500.000 lekë nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Duke menduar se të gjitha kursimet e saj ndodheshin pranë Raiffeisen dhe, në rast të falimentimit apo vjedhjes së kësaj të fundit, ajo mund të humbiste një shumë të konsiderueshme lekësh, vendosi të veprojë si më sipër.

Sqaroj se në kohën kur u plotësua deklarata e pasurisë nga nëna ime (janar 2017), kjo shumë ishte tërhequr dhe mbajtur në shtëpi nga ajo. Ajo nuk ka kuptuar faktin që duhej të deklaronte edhe shumat që dispononte në banesë, megjithatë vlerësojmë se në këtë rast këto shuma kanë qenë të deklaruar për sa kohë kanë qenë në bankë dhe thjesht janë tërhequr dhe janë rihedhur në banka të tjera, një pjesë e harxhuar për nevoja familjare, në një periudhë të shkurtër kohe rreth 5 muaj, pra që nga muaji tetor 2016 deri në shkurt 2017.

Në lidhje me burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, shpjegimi ynë është i njëjtë me atë të dhënë më sipër për llogarinë bankare të nënës sime pranë Raiffeisen Bank.

Në lidhje me sa më sipër, po ju vë në dispozicion dokumentacionet bankare nga Raiffeisen Bank, BKT dhe OTP Bank.

Veç sa më sipër, kërkoj nga ana juaj që të mbani në konsideratë faktin e njohur tashmë, që në vitet kur prindërit e mi kanë krijuar pjesën më të madhe të kursimeve të tyre, kemi pasur një ekonomi informale; faktin që nga ana ime ka qenë e vështirë gjetja e dokumentacionit edhe për shkak të humbjes/shkatërrimit të tij gjatë vitit 1997, si dhe faktin që çdo kursim apo e ardhur e prindërve të mi është realizuar prej tyre gjatë kohës që nuk kam qenë në ushtrim të detyrës aktuale dhe se në asnjë moment nuk kam kontribuar në llogari të krijuara prej tyre. Gjithashtu, kërkoj mirëkuptimin tuaj në lidhje me pasaktësitë në deklaram të kryer nga prindërit e mi, për shkak të padijenisë dhe pamundësisë së tyre për të kuptuar dhe perceptuar detyrimin ligjor për të deklaruar të ardhurat e tyre, edhe ato të disponuara në shtëpi prej tyre, për të cilat unë nuk kam pasur në asnjë moment dijeni dhe jam vënë në dijeni vetëm pasi nga ana juaj janë kërkuar shpjegimet e mësipërme”.

37.4 Nga verifikimi i llogarive bankare prej Komisionit, rezulton se nëna e subjektit në muajin tetor dhe dhjetor të vitit 2016 depozitat e saj në BKT dhe RFZ Bank, në shumën totale prej 15.000.000 lekësh, i ka pakësuar me 6.973958 lekë. Në 23.2.2017, nëna e subjektit ka depozituar sërish në BKT dhe OTP Bank shumën prej 4 milionë lekësh, të cilën sipas shpjegimeve të subjektit e ka disponuar *cash*, midis këtyre dy periudhave tetor 2016 – shkurt 2017. Nga verifikimi i deklaratave *Vetting* konstatohet se nëna e subjektit nuk ka deklaruar gjendjen *cash* të disponuar.

37.5 Referuar legjislacionit në fuqi, subjektet deklaruese, ku përfshihet dhe nëna e subjektit, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milionë lekë. Për subjektet që deklarojnë, depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve *cash* mbi vlerën e parashikuar më sipër, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Konstatime të Komisionit

37.6 Për sa më sipër, konstatohet se:

- Nëna e subjektit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shumën prej 6.9 milionë lekësh të disponuar *cash* më 31.12.2016.
- Prindërit e subjektit nuk do të kishin burime të ligjshme për krijimin e shumën 4.000.000 lekë të depozituar në 2017-ën, nëse prezumohet se tërheqjet *cash* në 2016-ën janë shpenzuar nga ana e tyre.
- Nëna e subjektit ka disponuar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, mbi limitin e lejuar nga ligji.

37.7 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të Nenit D të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

37.8 Në lidhje me këto konstatime, subjekti ka shpjeguar se është i vërtetë fakti që nëna e tij nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shumën e lekëve që dispononte *cash* në momentin e deklarimit, si dhe fakti se kjo vlerë është mbi limitin e lejuar nga ligji. E, megjithatë, kjo ka rezultuar për shkak se nuk kishte dijeni që duhet të deklaronte edhe për shuma lekësh që mund të dispononte jashtë sistemit bankar dhe aq më pak nuk kishte dijeni se sa mund të kishte qenë vlera e lejuar.

37.9 Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ky fakt nuk i ishte bërë i njohur nga prindërit e tij deri në momentin që i janë kërkuar shpjegime prej Komisionit dhe ka konstatuar lëvizjet që ata kanë kryer në llogaritë e tyre bankare, pasi ka kërkuar dokumentacionin përkatës bankar, me qëllim për të dhënë shpjegime para Komisionit.

37.10 Në shpjegimet e mëparshme që subjekti ka dhënë lidhur me këtë situatë, ka theksuar faktin që në kushtet kur nëna e tij të gjitha kursimet e jetës së saj i kishte në një llogari bankare pranë Raiffeisen Bank, ndërkohë që mori dijeni të faktit që bankat siguronin klientin e tyre deri në shumën 2.500.000 lekë, vlerësoi që një shumë të caktuar ta tërhiqte nga llogaria bankare e Raiffeisen Bank dhe ta vendoste në banka të tjera, ndërkohë që një pjesë do e mbante për ta shpenzuar për nevoja familjare. Nëse supozohet se do të shpenzonte të gjithë shumën, vërtet nuk do të kishte mundësi të depozitonte shumën prej 4.000.000 lekësh. Subjekti është shprehur se: *“Fakti që ajo shumë është depozituar, si dhe fakti që nuk ka asnjë të dhënë që në shtëpinë time të ketë pasur ndonjë event të asaj natyre, që do të kërkonte një shpenzim kaq të madh (6.900.000 lekë), të çon në të vetmin përfundim logjik, që shuma prej 4.000.000 lekësh, e depozituar në shkurt të vitit 2017 në BKT dhe OTP Bank, e ka burimin tek tërheqjet bankare të realizuara më parë”*. Subjekti ka pretenduar se thjesht fakti që prej prindërve të tij nuk është deklaruar gjendja *cash*, duke supozuar se e gjithë shuma është shpenzuar pa pasur asnjë indicie apo provë shoqëruese, nuk duhet të merret në konsideratë nga Komisioni.

37.11 Gjithashtu, subjekti ka theksuar se të gjitha gjetjet dhe konstatimet e Komisionit u referohen të ardhurave të krijuara nga prindërit, në një periudhë kur subjekti ka qenë i mitur dhe gjatë kohës që ka qenë me studime, si dhe në shumicë në një periudhë për të cilën vetë institucionet shtetërore nuk disponojnë dokumentet e nevojshme.

37.12 Subjekti ka theksuar se për krijimin e pasurive të prindërve nuk ka pasur asnjë kontribut financiar, si dhe asnjë mundësi objektive që të provojë me dokumente, për sa kohë, siç referohet

edhe nga DRT-ja Korçë, një pjesë e dokumentacionit nuk disponohet prej tyre për shkak të trazirave të vitit 1997. Subjekti ka pretenduar se ky fakt duhet të kihet parasysh nga Komisioni për një vlerësim dhe gjykim sa më objektiv dhe të drejtë të kriterit të pasurisë.

Arsyetimi i Komisionit

37.13 Në lidhje me likuiditetet *cash* të padeklaruara prej nënës së subjektit, nga hetimi i thelluar i Komisionit në asnjë moment nuk rezultoi ndonjë e dhënë që subjekti të kish ndikuar në krijimin e tyre e, për rrjedhojë, Komisioni krijoi bindjen se këto likuiditete e kanë burimin nga pakësimi i depozitave të krijuara vite më parë nga prindërit, si dhe përtej çdo dyshimi të jenë krijuar në momentin e depozitimit, nisur nga koha e shkurtër e kryerjes së veprimeve bankare, si tërheqja dhe ridepozitimi në dy banka të ndryshme pas një muaji nga deklarata *Vetting*. Këto fakte përputhen me provat dhe shpjegimet e subjektit, e si të tilla u pranuan nga Komisioni për një vlerësim objektiv të çështjes, pasi duket se mosdeklarimi i gjendjes *cash* në shtëpi nuk ka pasur për qëllim fshehjen e tyre, por duket se ka të bëjë me një neglizhencë nga ana e personit të lidhur. Fakti që këto likuiditete *cash* gjendeshin në shtëpi më 31 dhjetor të 2016 dhe duhej të ishin deklaruar në deklaratën *Vetting*, si një shkak i vetëm dhe i veçuar, përfundimisht mbetet një pasaktësi në deklaram. Një vlerësim ndryshe do ta penalizonte subjektin, duke rënduar me pa të drejtë pozitën e tij në këtë proces.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

37.14 Nga vlerësimi në tërësi i pasurive të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se nga deklaramet në deklaratën *Vetting* nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklaram të rremë.

37.15 Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen, për një vlerësim sa më objektiv, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, të cilat passjellin pasaktësi në deklaramin e subjektit lidhur me burimet e ligjshme që kanë shërbyer për investimet në pasurinë e prindërve, në raport edhe me deklaramet e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, Komisioni çmon se proporcionalisht këto konstatime, si një shkak i vetëm dhe i veçuar, nuk janë të mjaftueshme për penalizimin e subjektit në këtë proces, në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 84/2016.

37.16 Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

38. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në Nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

38.1 AKSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016³¹ mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit z. Ervin Xihani në detyrën e ndihmësit ligjor.

Vlerësimi i Komisionit

38.2 Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga AKSIK-ja të vitit 2017, për të cilin nuk kemi marrë informacion shtesë.

38.3 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

38.4 Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Xihani, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklaratime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

39. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga KLGJ-ja³² për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit.

39.1 Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit Ervin Xihani është kryer nga KLGJ-ja, i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dokumentet ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

39.2 Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;

³¹ Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. *** prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 8.8.2023.

³² Me nr. *** prot., datë 2.6.2023.

ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

39.3 Nga 3 dokumentet e depozituara nga subjekti dhe 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Ervin Xhiani në cilësinë e ndihmësit ligjor.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË

- 40.** Për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Xhiani, nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për shkak se ndihmësit ligjor janë njësi e brendshme e organizuar dhe vareshin nga gjykatat administrative ku ushtronin detyrën. Për rrjedhojë, të dhënat profesionale dhe etike për këtë subjekt i kemi marrë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, ku ai ka ushtruar detyrën si ndihmës ligjor.

ANALIZA E GJETJEVE

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

41.1 Procesi i rivlerësimit kalimtar të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative parashikohet dhe rregullohet nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga neni 165 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

41.2 Kështu, në nenin 165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, në mënyrë taksative parashikohet se: *“Këshilltari i gjyqarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

41.3 Ndërkohë, neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në:*

a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura;

b) rezultatet e testimiit pranë Shkollës së Magjistraturës.

41.4 Referuar parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi për kohën kur kryhet ky proces vlerësimi profesional, për ndihmësit ligjorë, ndryshe nga magjistratët-gjyqtarë, nuk ka pasur të miratuar nga një organ kompetent një sistem vlerësimi profesional. Për rrjedhojë, për ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative nuk ka kritere matëse të punës, sikurse ato kanë ekzistuar për magjistratët-gjyqtarë, prandaj vlerësimi i aftësive profesionale të tyre nuk ndjek detyrimisht të njëjtat rregulla sikurse për magjistratët-gjyqtarë.

41.5 Në këto kushte, vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative është kryer në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar më vonë.

41.6 Lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Xihani, për zotërimin prej tij të njohurive ligjore mund të themi si vijon:

Nga verifikimi i përmbajtjes së shkresës nr. * prot., datë 14.1.2017, të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, rezultoi se z. Ervin Xihani ka filluar punë si ndihmës ligjor pranë asaj Gjykate në datën 18.6.2015.

41.7 Për periudhën objekt i rivlerësimit kalimtar (8.10.2013 –8.10.2016), z. Xihani ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor për 1 vit e 4 muaj. Referuar parashikimit të nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016: *“Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se tri vite në detyrë, periudhë e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës”*.

41.8 Ndërkohë, para emërimit në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, z. Xihani ka pasur edhe eksperiencë të tjera në fushën e së drejtës. Kështu, për periudhën qershor 2006 – gusht 2009 z. Xihani ka kryer detyrën e juristit pranë Bashkisë Pogradec. Gjithashtu, në periudhën janar 2010 – qershor 2015, z. Xihani ka qenë i vetëpunësuar si avokat pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dega Pogradec.

41.9 Referuar të dhënave të mësipërme, mund të themi se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Xihani, ka eksperiencë të mjaftueshme për të ushtruar detyrën e këshilltarit ligjor (ndihmësit ligjor) pranë gjykatave administrative.

41.10 Ndihmësi ligjor është njësi ndihmëse, pjesë e organizimit të brendshëm të gjykatave administrative. Në nenin 6, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor.”* Në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, detajohen detyrat e ndihmësit ligjor, ku shprehimisht thuhet: *“Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material, që lidhen me çështjet në gjykim”*.

41.11 Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative, përfshirë këtu subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Xihani, do të mbështetet edhe në parashikimin ligjor të sipërcituar, pra në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”.

41.12 Në lidhje me njohuritë ligjore të zotëruara nga z. Ervin Xihani, të konstatuara nga dokumentet e vëzhguara, mund të konkludojmë se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Xihani, në relacione, por edhe në draftvendimet e përgatitura prej tij, manifeston njohuritë e duhura ligjore

për të prezantuar saktë çështjen objekt gjykimi, duke rreshtuar, por edhe analizuar pretendimet e prapësimet e palëve, duke identifikuar drejt legjislacionin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes, dhe jep propozim konkret për gjyqtarin për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

41.13 Në aktet e analizuara për këtë subjekt rivlerësimi spikasin njohuritë ligjore të përfituara, si dhe njehe zbaton në çështjet që trajton sipas rastit edhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësit ligjor, z. Ervin Xhiani, bazuar në rezultatet e testimit të zhvilluar në Shkollën e Magjistraturës

41.14 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Xhiani, ka përmbushur detyrimin e parashikuar nga neni 165, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë pjesë në testimin e aftësive profesionale të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës enkas për ndihmësit ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit.

41.15 Kështu, Shkolla e Magjistraturës, Këshilli Drejtues, me vendimin nr. **, datë 21.5.2018, ka vendosur: Të miratojë rezultatet e testimit profesional të subjekteve *ex officio* të shpallura nga Komisioni i mbikëqyrjes së vlerësimit elektronik (faza e parë) dhe Komisioni i vlerësimit të testit (faza e dytë), sipas listave bashkëngjitur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

41.16 Nga përmbajtja e të dhënave të evidentuara në tabelën me pikët përfundimtare të fazës së dytë, pjesë përbërëse e vendimit nr. **, datë 21.5.2018, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, rezultoi se ndihmësi ligjor Ervin Xhiani mori në total 81 pikë, nga 200 pikë, që ishte maksimumi i parashikuar në tabelë.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

41.17 Nga të dhënat statistikore të deklaruara nga vetë ndihmësi ligjor z. Xhiani, por edhe ato të dhëna të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë për efekt të shortit, mund të themi se subjekti i rivlerësimit ka përballuar një ngarkesë relativisht të lartë pune dhe ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtarët të cilëve u ka asistuar.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

41.18 Referuar akteve që rregullojnë detyrat e ndihmësit ligjor, rezultoi se ndihmësi nuk kryen procedura gjyqësore. Ky kriter vlerësimi shërben dhe zbatohet vetëm për gjyqtarin, i cili i ka të përcaktuara qartësisht në ligj detyrat e tij procedurale, duke filluar që nga data e marrjes me short të çështjes e deri në datën e përfundimit të saj me vendim përfundimtar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

41.19 Edhe ky kriter vlerësimi zbatohet vetëm për gjyqtarët. As në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe në asnjë ligj apo akt nënligjor tjetër nuk parashikohet si detyrë për ndihmësin që të administrojë një dosje gjyqësore.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

41.20 Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 3.5.2023, nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të z. Ervin Xhiani për periudhën gjatë së cilës ai ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë asaj Gjykate. Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezultoi se nga verifikimet e kryera nuk rezultojnë shkelje apo masa disiplinore për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Xhiani, për periudhën 18.6.2015 – 8.10.2016.

b) Integriteti

41.21 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit z. Ervin Xhiani, ato të dërguara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, por edhe nga dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna negative në lidhje me imunitetin e subjektit të rivlerësimit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

41.22 Ky element vlerësues është tipik për gjyqtarin, i cili ka detyrimin ligjor jo vetëm të jetë i paanshëm në një proces gjyqësor, por edhe të silltet si i tillë sipas parimit “Drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe duhet të duket se po jepet”.

41.23 Ndihmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndihmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues, asistues i gjyqtarit.

41.24 Në tri relacionet dhe në pesë draftvendimet e përgatitura nga ndihmësi ligjor Ervin Xhiani nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që u korrespondojnë atyre projektvendimeve.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

41.25 Në aktet e vëzhguara nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Ervin Xhiani me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej tij mund të vlerësohet si korrekte dhe normale.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

41.26 Në aktet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, me kolegët e tyre dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjërin prej relacioneve apo edhe projektvendimet e vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarët të cilëve u ka asistuar.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

41.27 Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Xhiani, ka marrë pjesë dhe është certifikuar në tri trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Temat e trajnimit lidhen me fushën administrative, pra me çështje objekt i punës së ndihmësit ligjor në gjykatat administrative.

DENONCIME

42. Pranë Komisionit janë depozituar 2 denoncime nga shtetaset J.P³³ dhe L.B³⁴ për subjektin e rivlerësimit, ku ndër të tjera referohet se subjekti Ervin Xhiani, për shkak të miqësisë me avokatin B.H, ka ndikuar tek prokurorja V.P, për të ndryshuar kualifikimin e veprës penale të një shtetasi në hetim, akuzuar për një vrasje në qytetin e Pogradecit. Nga deklaratimet e subjektit, si dhe rrethanat e pasqyruara në denoncim, rezulton se znj. V.P ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, si dhe është nëna e dy fëmijëve të subjektit të rivlerësimit.

42.1 Në datën 12.9.2024, trupi gjykues vendosi të riçelë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Ervin Xhiani, për kryerjen e disa verifikimeve për rrethanat e cilësuar në denoncimet e paraqitura.

42.2 Komisioni kërkoi informacion në lidhje me adresat e banimit të subjektit të rivlerësimit Ervin Xhiani, si dhe shtetases V.P, pasi subjekti ka deklaruar si gjatë hetimit, ashtu dhe në deklaratën *Vetting* se ka banuar me prindërit e tij.

42.3 Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për t'u informuar në lidhje me shkaqet e dorëheqjes së prokurores V.P nga çështja penale e regjistruar me nr.***, në ngarkim të shtetasis D.M etj.

42.4 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë³⁵ ka depozituar praktikën e zëvendësimit të prokurores V.P nga procedimi penal me nr. ***, të regjistruar në ngarkim të shtetasis D.M, procedim ende në hetim.

Në vendimin e zëvendësimit të prokurores arsyetohet se: *“Në datën 15.8.2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është paraqitur kërkesa e znj. J.P për zëvendësimin e prokurores V.P nga çështja penale e regjistruar në ngarkim të shtetasis D.M.*

Në kërkesën e paraqitur nga kjo shtetase pretendohet se prokurorja e çështjes është në kushtet e ekzistencës së shkaqeve të rëndësishme të njëanshmërisë, të tilla që mund të ndikojnë nivelin e hetimit, dhe si rezultat edhe të zbulimit, dokumentimit dhe provueshmërisë së ekzistencës së veprës penale. Në lidhje me shkaqet e njëanshmërisë përcaktojmë faktin e regjistrimit të procedimit penal, dukshëm jo i bazuar në rrethanat e faktet e referuara nga policia, si dhe moskryerjen e veprimeve të para hetimore të ngutshme në kuadër të njoftimit nga policia për ngjarjen, si dhe kërkimin e masës së detyrimit për t'u paraqitur për tre persona, të cilët nga përmbajtja e deklaratimeve, kontradiktore me veten dhe ndërmjet tyre, gjë që tregon rrezikshmëri të theksuar shoqërore, të paktën në drejtim të fshehjes së autorit dhe të veprimeve kriminale të këtij të fundit.

Gjithashtu, kjo shtetase ka pretenduar për lidhje të ngushta shoqërore mes avokatit të të pandehurve B.H dhe bashkëjetuesit të prokurores së çështjes. Përveç fotove që të sjellin dyshime,

³³ Me nr. *** prot., datë 12.9.2024.

³⁴ Me nr. *** prot., datë 12.9.2024.

³⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2024.

kemi mungesën e profesionalizmit për shkaqet që përmenda më lart, të çojnë në dyshimin për njëanshmëri...”

Ndërkohë që edhe nga ana e prokurores V.P është paraqitur deklarata për zëvendësimin e saj si prokurore e çështjes, dhe ndër të tjera prokurorja shkruan se “gjatë ushtrimit të këtij funksioni nuk kam pasur asnjë marrëdhënie miqësore me avokatin B.H dhe është njohur prej meje thjesht si një avokat. Gjithashtu, theksoj faktin që av. B.H është mbrojtës i shtetasit V.Sh, i cili dyshohet për “Moskallëzim krimi” dhe jo i të dyshuarit për vrasjen e viktimës.

Në asnjë moment nuk jam ndier në kushte njëanshmërie gjatë hetimit të kësaj çështjeje, përkundrazi, kam vepruar me objektivitet maksimal, fakt që u përkthye në sulm mediatik ndaj meje.

Pavarësisht gjithë opinionit publik të shfaqur, sulmit mediatik, komenteve dashakeqe për punën time, pastërtinë e figurës dhe për mua personalisht, vlerësoj se kam treguar vetëpërmbytje, kam ruajtur objektivitetin, kam respektuar maksimalisht kërkesat e trashëgimtarëve të viktimës, i kam njohur me aktet e dosjes dhe kam proceduar me marrjen e provave të kërkuara prej tyre deri në momentin e përpilimit të kësaj deklarate”.

42.5 *Prokuroria e Rrethit Korçë në shkresën e saj referon se nga ana e prokurores V.P është bërë një vlerësim fillestar i provave të administruara nga policia gjyqësore në momentet e para të referimit të veprës penale, ndërkohë që nga ana e saj ka vijuar në dinamikë kryerja e veprimeve të tjera hetimore, të cilat vlerësoj në fakt se do të hidhnin dritë në mënyrë të plotë për konfigurimin e saktë të veprës penale, që do t’u atribuohet personave të dyshuar në këtë vepër penale.*

Në kushtet kur familjarët e viktimës kanë pretendime sa i takon prokurores së çështjes, por edhe në kushtet kur vlerësojmë shumë të rëndësishme jo vetëm vërtetësinë e hetimit, por edhe perceptimin e paanshëm të këtij hetimi nga ana e palëve, vlerësoj se jemi në kushtet e zëvendësimi të prokurores nga hetimi i kësaj çështjeje penale”.

42.6 *Nga sa më sipër, rezultoi se prokurorja V.P nuk e ka mohuar njohjen me avokatin B.H, por ka deklaruar se si para hetimit të çështjes, edhe pas saj nuk ka pasur lidhje miqësore me këtë shtetas.*

42.7 *Komisioni kërkoi informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit³⁶ në lidhje me hyrje-daljet e subjektit. Sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Ervin Xhiani ka disa hyrje-dalje me shtetasin B.H, i cili ka vepruar si avokat për të pandehurit në çështjen penale ndaj shtetasit D.M etj., ku ka ngelur i vlarë një shtetas.*

42.8 *Në përgjigjet e pyetësorit për udhëtimet jashtë vendit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përdorur dhe udhëtuar disa herë me automjetin e shtetasit B.H, me targë AA *** MG.*

- ✓ *Nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se prokurorja V.P ka udhëtuar për herë të fundit në datën 6.8.2019 me automjetin e avokatit B.H.*

³⁶ Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 16.5.2024.

42.9 Komisioni në lidhje me vendbanimin e prokurores iu drejtua ILDKPKI-së, duke kërkuar deklaratimet periodike të prokurores V.P.

42.10 ILDKPKI-ja³⁷ ka depozituar deklaratimet e prokurores nga viti 2019 si studente e Magjistraturës dhe deklaratimet në vijim për vitet 2022 dhe 2023. Në të gjitha deklaratimet, prokurorja ka si adresë banimi rr. “P.Sh”, nd. **, h. *, fshati Drenovë, bashkia Korçë. Në deklaratimin e vitit 2022 (e kandidatit për pozicione të ndryshme në sistemin e drejtësisë), kur ka marrë emërimin në detyrën e prokurores në Prokurorinë e Rrethit Korçë, kjo prokurore ka deklaruar në përbërjen e saj familjare edhe 2 fëmijë, të lindur në datën 10.8.2021.

Në deklaratimin periodik vjetor të vitit 2022, kjo prokurore ka deklaruar shtetasin Ervin Xhiani (tek rrethi i personave të lidhur me subjektin), ku tek seksioni i shënimeve ka deklaruar: *“Shtetasi Ervin Xhiani është babai i fëmijëve të mi. Nuk është bashkëshorti apo bashkëjetuesi im. Në rubrikën “Lidhja me deklaruuesin” nuk konstatohet ndonjë opsion tjetër i përshatshëm, veçse “i njohur” për të treguar lidhjen time me këtë shtetas”*.

42.11 Në procesverbalet e depozituara nga ILDKPKI-ja³⁸, të datës 9.3.2022, kjo prokurore ka shpjeguar se shtetasi Ervin Xhiani nuk është as bashkëshorti dhe as bashkëjetuesi i saj. Nuk ndajnë interesa pasurore apo financiare, përveç fëmijëve, duke e trajtuar subjektin e rivlerësimit Ervin Xhiani si “të njohur”.

42.12 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar³⁹ se: *“Që nga data e marrjes së detyrës sime, në mënyrë kronologjike janë këto ndryshime: në datën 7.10.2019, unë jam ndarë nga trangu familjar i babait tim dhe figuroj i vetëm si kryefamiljar. Në datën 10.8.2021 kanë lindur dy fëmijët e mi (binjakë) J dhe A, amësia V.E.P, të cilët figurojnë në trangu familjar të nënës së tyre. Kjo pasi unë kam bërë vetëm njohjen e atësisë dhe fëmijët rrinë pranë nënës së tyre, sepse unë nuk bashkëjetoj me ta. Unë me shtetasen V.P deri më sot nuk kemi bashkëjetuar dhe ende nuk bashkëjetojmë, pavarësisht lindjes së dy fëmijëve. Shtetasja V.P ka jetuar në familjen e saj dhe unë në familjen time, dhe nuk kemi lidhur martesë ligjore”*.

42.13 Nga hetimi konstatohet si vijon:

- ✓ Subjekti Ervin Xhiani ka udhëtuar dhe përdorur automjetin e avokatit/shtetasit B. H;
- ✓ Po ashtu, nga të dhënat e sistemit TIMS, shtetasja V.P ka udhëtuar disa herë me automjetin e avokatit B.H, së bashku me z. Ervin Xhiani;
- ✓ Në deklaratimet e saj, shtetasja V.P nuk e ka mohuar njohjen me avokatin B.H, por ka deklaruar se si para hetimit të çështjes, edhe pas saj nuk ka pasur lidhje miqësore me këtë shtetas;

42.14 Nisur nga këto fakte, Komisioni:

- i ka kërkuar subjektit shpjegime lidhur me pretendimet e denoncueses;

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2024.

³⁸ Janë sjellë në Komision nëpërmjet shkresës së ONM-së me nr. ***, datë 18.9.2024.

³⁹ Në përgjigjet e pyetësorit standard, ardhur në datën 24.9.2021.

- i ka kërkuar të depozitohet aktin e përfaqësimit të avokatit B.H në lidhje me çështjen penale nr. **/2024.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

42.15 Në prapësimet e rezultateve të hetimit të datës 27.9.2024, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se faktet e pretenduara nga denoncuesja janë të pavërteta e tendencioze, pasi prokurorja V.P nuk është bashkëshortja dhe as bashkëjetuesja e tij. Subjekti ka shpjeguar marrëdhënien personale me shtetasen V.P, prej së cilës kanë lindur edhe dy fëmijët e tyre në datën 10.8.2021. Për shkak të rrethanave familjare dhe kushteve shëndetësore të vajzës së subjektit, si dhe për shkak të faktit që shtetasja V.P është emëruar si prokurore në qytetin e Korçës (kjo edhe me qëllimin për të pasur ndihmën e nënës së saj në rritjen e fëmijëve, shtetasja V.P ka jetuar me prindërit e saj, në banesën e këtyre të fundit në fshatin Drenovë, bashkia Korçë; ndërsa subjekti ka vazhduar jetesën në qytetin e Pogradecit, sipas adresës që ka deklaruar). Subjekti ka sqaruar se i ka vizituar shpesh fëmijët, gjatë kohës që ka qenë i punësuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe, më pas, edhe për shkak të krijimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku tashmë ushtron funksionin, bashkëjetesa me shtetasen V.P dhe fëmijët e tij ka qenë objektivisht e pamundur.

42.16 Subjekti ka shpjeguar se nga ana e prokurores V.P, në asnjë moment deri kur ajo është zëvendësuar nga hetimi i dosjes me pëlqimin e saj, nuk është ngritur asnjë akuzë ndaj asnjë personi të dyshuar për vrasjen e të ndjerit E.P. Kur materiali kallëzues është referuar nga policia dhe aktet janë marrë nga prokurorja, ajo ka proceduar me regjistrimin fillestar të procedimit penal për veprën penale “Vrasja nga pakujdesia”, duke vlerësuar se me provat që ndodheshin deri në atë moment në dosje, krijohej ky dyshim, duke qenë në tagrat e prokurorit cilësimi juridik i veprës penale dhe jo të policisë, ndryshe nga sa është pretenduar nga denoncuesja dhe transmetuar në media, nuk ka pasur ndonjëherë ndryshim akuze për lehtësim të pozitës së të dyshuarve, në kushtet kur nuk është ngritur asnjëherë akuzë. Masa e sigurimit të caktuar ndaj të dyshuarit sipas kërkesës së prokurores është ajo e arrestit në burg, pra nuk ka pasur ndonjë lehtësim pozite.

42.17 Subjekti ka theksuar se në aktet e para të përcjella nga policia mbrojtës i të dyshuarve ka qenë avokati E.M. Në dosjen hetimore në asnjë moment nuk është depozituar prokurë përfaqësimi për ndonjë nga të dyshuarit nga av. B.H. Pra, prokurorja deri në këtë moment procedural nuk ka pasur dijeni të faktit që mbrojtës i ndonjërit prej të dyshuarve mund të ishte av. B.H. Ky i fundit është paraqitur në seancën gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit në gjykatë dhe ka deklaruar se është mbrojtës i të dyshuarit V.Sh, i dyshuar për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, dhe jo i të dyshuarit D.M, i cili është i dyshuar për vrasjen e të ndjerit E.P. I dyshuari D.M edhe në seancën gjyqësore të caktimit të masës së sigurimit ka pasur avokat shtetasin E.M.

42.18 Subjekti ka shpjeguar se regjistrimi i procedimit penal nuk është ngritje akuze për një person të dyshuar. Procedimi penal regjistrohet nga prokurori për një veprë penale, që ai krijon dyshim se mund të ekzistojë në bazë të akteve të materialit kallëzues të përcjellë nga policia dhe vijohet me kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, derisa prokurori të krijojë bindjen se i dyshuari ka kryer një veprë penale të caktuar dhe se cilën veprë penale konkretisht. Në këtë moment procedural, prokurori mund të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale në regjistër, me një urdhër të thjeshtë, që është totalisht në tagrat dhe kompetencën e tij dhe në vijim t’i komunikojë edhe akuzën të dyshuarit, duke e marrë atë si të pandehur. Edhe sikur prokurori të ngriejë akuzë

për një veprë penale të caktuar, pasi ajo i përket bindjes së tij dhe kur çështja të shkojë në gjykatë, kjo e fundit ka të drejtë të ftojë prokurorin të bëjë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nëse vlerëson se nuk ndodhemi para veprës penale për të cilën prokurori ka ngritur akuzë.

42.19 Në lidhje me pretendimet e denoncuases që prokurorja V.P ka vepruar me njëanshmëri dhe e ndikuar nga subjekti dhe av. B.H, subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit vendimin e drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Korçë, znj. Dh.Th, e cila në asnjë moment nuk shprehet se është konstatuar ndonjë dyshim për njëanshmëri në punën e prokurores, por përkundrazi, cilësohet që prokurorja ka bërë vlerësim fillestar të provave, ka vijuar në dinamikë me kryerjen e veprimeve hetimore dhe në fund të tyre mund të konkludohet me një cilësim përfundimtar të veprës penale. Në kushtet kur çështja u bë mediatike, edhe me dhënien e pëlqimit nga prokurorja V.P, drejtuesja e prokurorisë në vendimin e saj shprehet që në kushtet e një perceptimi të paanshëm të hetimit bëhet zëvendësimi i prokurores, pra edhe në vendimarrjen e saj drejtuesja e prokurorisë shprehet për perceptim dhe jo për fakt të provuar për njëanshmëri të prokurores.

42.20 Gjithashtu, pas këtij rasti, drejtuesja e Prokurorisë së Korçë është vënë në dijeni nga prokurorja V.P edhe për dosjet hetimore që kjo e fundit po heton, ku avokat i ndonjërës nga palët mund të jetë av. B.H, por drejtuesja e prokurorisë nuk ka vendosur zëvendësimin e prokurores së çështjes, çka dëshmon edhe një herë se prokurorja nuk është në kushtet e konfliktit të interesit në këto raste.

42.21 Në lidhje me faktin se prokurorja V.P ka udhëtuar me automjetin e shtetasit B.H, subjekti ka sqaruar se ky fakt është i vërtetë dhe është pasqyruar prej tij edhe kur ka dhënë sqarimet për udhëtimet e tij, por ka theksuar se shtetasja V.P në atë kohë nuk ka qenë në ushtrim të funksionit të prokurores; ajo është emëruar prokurore në korrik të vitit 2022 dhe në asnjë moment nuk ka udhëtuar me avokatin B.H.

42.22 Makina është huazuar prej subjektit nga miku i tij B.H, për shkak të pasjes së siguracionit për dalje jashtë shtetit. Si para fillimit të detyrës nga prokurorja V.P, edhe gjatë ushtrimit të detyrës kjo e fundit që në fillim të lidhjes me subjektin ka pasur dijeni të faktit që ka një mik të quajtur B. H, me profesion avokat, por ajo asnjëherë nuk është përfshirë në marrëdhënie shoqërore apo akoma më tej familjare me avokatin B.H. Për sa më sipër, është e saktë edhe gjetja e Komisionit që prokurorja V.P e ka njohur av. B.H si të tillë në proceset gjyqësore ku kanë marrë pjesë, por asnjëherë ajo vetë nuk ka pasur marrëdhënie miqësie me të.

42.23 Pra, në lidhje me pretendimin e mësipërm të denoncuases, subjekti ka theksuar se nuk është e vërtetë që shtetasja V.P është bashkëshortja apo bashkëjetuesja e tij, nuk është e vërtetë që prokurorja V.P ka ngritur apo ka ndryshuar akuzën për të dyshuarin D.M, nuk është e vërtetë se av. B.H është mbrojtësi i të dyshuarit D.M për vrasjen e të ndjerit E.P.

42.24 Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë⁴⁰ për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasve të dyshuar D.M, V.Sh, A.M, nga ku rezulton se av. B.H nuk është avokat i të dyshuarve për vrasje, por avokat i të dyshuarit për veprën penale të moskallëzimit të krimit, shtetasit V.Sh.

⁴⁰ Me nr. vendimi *** (267 regj.), datë 13.8.2024.

42.25 Subjekti gjithashtu ka depozituar aktin e përfaqësimit⁴¹ të av. B.H, me të cilin i jepet e drejta të përfaqësojë në gjykatë shtetasin V.Sh, i dyshuar për veprën penale të moskallëzimit të krimit.

Vlerësimi i Komisionit

42.26 Komisioni, pas hetimit shtesë të kryer, si dhe pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në harmoni edhe me provat e paraqitura, vlerëson se në gjendjen që ndodhen aktet, nuk arrihet të provohen me prova të plota e të qenësishme pretendimet e denoncueses në lidhje me ndikimin e mundshëm të av. B.H tek prokurorja e çështjes V.P nëpërmjet subjektit të rivlerësimit.

42.27 Subjekti ka provuar me prokurën e depozituar, si dhe me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë se av. B.H nuk ka vepruar si avokat i të dyshuarit për vrasje, shtetasit D.M, të cilit u pretendua në denoncim se i është ndryshuar akuza duke ia lehtësuar pozitën si të pandehur, por ka qenë avokat i të dyshuarit për veprën penale të moskallëzimit të krimit, shtetasit V.Sh.

42.28 Për sa më sipër, pretendimet e denoncueses mbeten të paprovuara në lidhje me ndikimin e subjektit të rivlerësimit tek prokurorja e çështjes penale, e regjistruar me nr. ***/2024, në ngarkim të shtetasit me D.M etj.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

42.29 Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon kriterin profesional të ndihmësit ligjor Ervin Xhiani dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektiv dhe eficient në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional i aftë.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, si dhe pasi dëgjoji subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ervin Xhiani ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

⁴¹ Prokurë e posaçme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.8.2024.

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ervin Xihani, ndihmës ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
 2. Ky vendim i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, më 2.10.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha